

PROFETI JUSUF (as)



Njëmend, për ata që pyesin (interesohej),
në ndodhinë e Jusufit dhe të vëllezërve të tij pati fakte
(mbi fuqinë e Zotit). (Jusuf: 7)



HARUN YAHYA

RRETH AUTORIT



Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.



بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ



All translations from the Qur'an are from "The Noble Qur'an:
a New Rendering of its Meaning in English"
by Hajj Abdalhaqq and Aisha Bewley, published by Bookwork,
Norwich, UK. 1420 CE/1999 AH.

Website: [http:// www.harunyahya.com](http://www.harunyahya.com)

By Harun Yahya

PROFETI JUSUF

(AS)

*Njëmend, për ata që pyesin
(interesohen),
në ndodhinë e Jusufit dhe të
vëllezërve të tij pati fakte
(mbi fuqinë e Zotit). (Jusuf: 7)*

HARUN JAHJA
ADNAN OKTAR

PËR AUTORIN

Autori i cili shkruan me pseudonimin HARUN JAHJA, lindi në Ankara në vitin 1956. Me përfundimin e arsimit fillor dhe të mesëm në Ankara, ai mandej studioi artet në Universitetin Mimar Sinan të Stambollit dhe filozofinë në Universitetin e Stambollit. Që prej viteve të 1980-ta, autori ka botuar shumë libra lidhur me çështjet politike, besimin dhe çështjet shkencore. Harun Jahja është i mirënjohur si autor i cili ka shkruar libra shumë të rëndësishëm që zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre dhe lidhjet e errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi. Pseudonimi i tij përbëhet prej emrave "Harun" (Aron) dhe "Jahja" (Xhon), në kujtim të dy profetëve të respektuar të cilët luftuan kundër mungesës së besimit. Vula e Profetit në kopertinën e librave është simbolike dhe ka të bëjë me përmajtjet e tyre. Ajo përfaqëson Kuranin (Librin e shenjtë të fundit) dhe Profetin Muhammed (saas), profetin e fundit. Nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunnetit, autori ka për qëllim të përgënjeshtroj secilin prej parimeve themelore të ideologjive të pafe dhe të ketë "fjalën e fundit", në mënyrë që t'ua mbyll gojën plotësisht kundërshtimeve të ngritura kundër fesë. Vula e Profetit të fundit, i cili arriti urtësi kulminante dhe përsosje morale, përdoret si shenjë e qëllimit të tij për komunikimin e kësaj fjale të fundit.

Të gjitha veprat e autorit përqendrohen rreth një qëllimi: të bart porosinë e Kuranit tek njerëzit, t'i inkurajoj ata të mendojnë për çështjet themelore lidhur me besimin (si ekzistenca e Allahut, njëshmëria e Tij dhe Jeta e përtejme) dhe t'i demaskoj themelet e dobëta të ideologjive të coroditura të sistemeve të pafe.

Harun Jahja ka një rreth të gjerë lexuesish në shumë vende, nga India deri në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, nga Polonia në Bosnje dhe nga Spanja në Brazil. Disa nga librat e tij janë në dispozicion në Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Portugalisht, në gjuhën Urdu, Arabe, Shqipe, Ruse, Serbo-Kroate (Boshnjake), Polake, Malajase, Ujgur Turke dhe Indoneziane dhe ato pëlqehen nga lexues në mbarë botën.

Këto vepra, shumë të çmuara në mbarë botën, kanë qenë të dobishme për shumë njerëz për të përmirësuar besimin e tyre në Allahun dhe për shumë të tjerë për të fituar një dituri më të thellë për besimin e tyre. Urtësia dhe stili i sinqertë dhe i lehtë për t'u kuptuar ju jap këtyre librave një karakteristike të veçantë e cila ka ndikim të drejtpërdrejt tek çdokush i cili i lexon apo studion ato. Rezistente ndaj kundërshtimeve, këto vepra karakterizohen me veçoritë e tyre të efikasitetit të shpejtë, rezultateve të sakta dhe pakundërshtueshmërisë. Është e pamundur që ata të cilët i lexojnë këta libra dhe mendojnë seriozisht për to të vazhdojnë të mbrojnë sinqerisht filozofinë materialiste, ateizmin ose cilëndo ideologji apo filozofi tjetër të shtrembëruar. Madje edhe nëse vazhdojnë ta bëjnë këtë, do të jetë kjo vetëm një këmbëngulje sentimentale pasi që këta libra përgënjeshtrojnë ideologjitë e tilla që nga themelet e tyre. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore të mohimit tani janë të mposhtura ideologjikisht, duke iu falënderuar përmbledhjes së librave të Harun Jahjasë.

Nuk ka dyshim se këto tipare rezultojnë prej urtësisë dhe qartësisë së Kuranit. Autori me modesti ka për qëllim të shërbej si mjet i kërkimit të rrugës së drejtë të Allahut nga njerëzimi. Me publikimin e këtyre veprave nuk kërkohet përfitim material.

Duke i marrë parasysh këto fakte, ata të cilët i inkurajojnë njerëzit për t'i lexuar këta libra, të cilët i hapin "sytë" e zemrës dhe i udhëzojnë për t'u bërë shërbëtor më të devotshëm të Allahut, bëjnë një shërbim shumë të çmueshëm.

Në ndërkohë, do të ishte vetëm humbje kohe dhe energjie të përhapen libra tjerë të cilët krijojnë huti në mendjet e njerëzve, shpijen njeriun në rrëmujën ideologjike dhe të cilët sheshazi nuk kanë rezultate të fuqishme dhe të sakta për largimin e dyshimeve nga zemrat e njerëzve, siç është vërtetuar edhe nga përvoja e mëparshme. Është e qartë se është e pamundshme që librat e sajuar për të theksuar fuqinë letrare të autorit më tepër se sa qëllimin fisnik të shpëtimit të njerëzve nga humbja e besimit, të kenë një ndikim aq të madh. Ata të cilët dyshojnë për këtë lehtë mund të kuptojnë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtet mosbesimi dhe të përhapen vlerat morale të Kuranit. Sukseset dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqet në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet ta kemi parasysh: arsyeja kryesore për egërsinë që vazhdon, konfliktin dhe të gjitha përvojat e hidhura të cilave ju nënshtrohen shumica e njerëzve është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kjo gjendje mund të përfundojë vetëm me disfatën ideologjike të mosbesimit dhe me komunikimin e mrekullive të krijimit dhe të parimeve morale të Kuranit në mënyrë që njerëzit të jetojnë në pajtim me to. Duke e pasur parasysh gjendjen e botës sot, e cila i shpie njerëzit në tatëpjetën e spirales së dhunës, në korrupsion dhe konflikt, është e qartë se ky shërbim duhet të ofrohet më shpejtë dhe në mënyrë efikase. Përndryshe, mund të jetë tepër vonë.

Nuk është e tepërt të themi se kjo përmbledhje e librave të Harun Jahjasë ka marr këtë rol ud-

hëheqës. Me vullnetin e Allahut, këta libra do të jenë mjet përmes të cilit njerëzit e shekullit 21 do të arrijnë paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

Veprat e autorit përfshijnë: Rendi i Ri Mason, Judaizmi dhe Masoneria, Masoneria Globale, Kabala dhe Masoneria, Kalorësit e Tempullit, Islami Dënon Terrorizmin: Terrorizmi: Ritualitë dhe Djallit, Fatkeqësitë që Darwinizmi ia sollti Njerëzimit, Komunizmi në pritë, Fashizmi: Ideologjia e Përgjakshme e Darwinizmit, "Dora e fshehtë" në Bosnje, Prapa skenës së Holokaustit, Prapa skenës së Terrorizmit, Letra Kurde e Izraelit, Politika e shtypjes e Kinës komuniste dhe e Turkestanit Lindor, Palestina, Zgjidhja: Vlerat e Kuranit, Dimri i Islamit dhe Pranvera që do të vijë, Artikujt 1-2-3, Një Armë e Shejtanit: Romanticizmi, Drita e Kuranit asgjësoi Satanizmin, Argumentet nga Kapitulli i Shpellës deri te Kohërat e Fundit, Shenjat e Ditës së Fundit, Kohërat e Fundit dhe Bisha e Tokës, Të vërtetat 1-2, Bota Perëndimore i kthehet Zotit, Mashtrimi i Evolucionit, Përgjigjet e sakta për evolucionistët, Gafet e evolucionistëve, Pranimet e evolucionistëve, Ideja e gabuar e Evolucionit të Specieve, Kurani mohon Darwinizmin, Popujt e Zhdukur, Për njerëzit që posedojnë arsye, Profeti Musa (as), Profeti Muhammed (saas), Profeti Sulejman (as), Koha e Artë, Mjeshtëria e Allahut në Ngjyra, Madhështia është gjithandej, Rëndësia e Dëshmive të Krijimit, E vërteta e Jetës së kësaj bote, Ankthi i mosbesimit, Njohja e të vërtetës, Përjetësia tashmë ka filluar, Përjetësia dhe Realiteti i Fatit, Materia: Një tjetër emër për Iluzionin, Njeriu i vogël në Kullë, Islami dhe Filozofia e Karmës, Magjia e zezë e Darwinizmit, Feja dhe Darwinizmi, Dështimi i Teorisë së Evolucionit në 20 pyetje, Projektimi në natyrë, Teknologjia imiton natyrën, Rruga pa krye e Evolucionit 1 (libër enciklopedik), Rruga pa krye e Evolucionit 2 (libër enciklopedik), Allahu njihet përmes arsyes, Kurani udhëheq rrugën drejt shkencës, Zanafilla e vërtetë e jetës, Vetëdija në qelizë, Teknologjia imiton natyrën, Një varg i mrekullive, Krijimi i Gjithësisë, Mrekullitë e Kuranit, Projektimi në natyrë, Vet-flijimi dhe modelet e sjelljes inteligjente të kafshëve, Fundi i Darwinizmit, Të menduarit e thellë nuk e mbron kurrë mosdijen, Mrekullia e gjelbër: Fotosinteza, Mrekullia në qelizë, Mrekullia në sy, Mrekullia në merimangë, Mrekullia në mushkonjë, Mrekullia në milingonë, Mrekullia e Sistemit të Imunitetit, Mrekullia e krijimit në bimë, Mrekullia në atom, Mrekullia në bletë, Mrekullia e farës, Mrekullia e hormonit, Mrekullia e termitit, Mrekullia e organizmit njerëzor, Mrekullia e krijimit të njeriut, Mrekullia e proteinës, Mrekullia e nuhatjes dhe shijimit, Mrekullia e mikrobotës, Fshehtësitë e ADN-së.

Librat e autorit për fëmijë janë: Mrekullitë e Krijimit të Allahut, Bota e Kafshëve, Madhështia në Qiej, Krijesat e mrekullueshme, Ta mësojmë Islamin tonë, Mrekullitë në Organizmat tonë, Bota e shokëve tonë të vegjël: Milingtonat, Bletët që ndërtojnë hoje të përkryera, Ndërtuesit e shkathhtë të pendëve: Kastorët.

Veprat tjera të autorit mbi temat Kuranore përfshijnë: Konceptet themelore në Kuran, Vlerat morale të Kuranit, Kuptimi i shpejtë i Besimit 1-2-3, Keni menduar ndonjëherë për të vërtetën?, Kuptimi i vrazhdë i mosbesimit, I devotshëm ndaj Allahut, Braktisja e shoqërisë ku mbretëron mosdija, Shtëpia e vërtetë e besimtarëve: Parajsja (Xheneti), Njohja e Kuranit, Indeksi i Kuranit, Mërgimi për hir të Allahut, Karakteri i hipokritit në Kuran, Fshehtësitë e hipokritit, Emrat e Allahut, Komunikimi i porosisë dhe Debatit në Kuran, Përgjigjet nga Kurani, Vdekja Ringjallja Ferri (Xhehenemi), Lufta e të Dërguarve, Armiku i përbetuar i njeriut: Shejtani, Shpifja më e madhe: Idhujtaria, Feja e të padijshmit, Mendjemadhësia e Shejtanit, Lutja në Kuran, Teoria e Evolucionit, Rëndësia e Vetëdijes në Kuran, Dita e Ringjalljes, Kurrë mos harro, Mendimet e shpërfillura të Kuranit, Karakteret e njeriut në shoqërinë ku mbizotëron mosdija, Rëndësia e durimit në Kuran, Informacioni i përgjithshëm në Kuran, Feja e arrirë, Para se të pendoheni, Të Dërguarit tonë thonë, Mëshira e besimtarëve, Frika ndaj Allahut, Jezusi do të kthehet, Bukuritë e paraqitura nga Kurani për jetën, Një buqetë e bukurive të Allahut 1-2-3-4, Ligësia e quajtur "Tallje", Misteri i testit, Urtësia e vërtetë sipas Kuranit, Lufta kundër Religjionit të Mosbesimit, Shkolla e Jusufit, Aleanca e të mirës, Shpifjet e përhapura kundër Myslimanëve përgjatë historisë, Rëndësia e pasimit të Fjalës së Mirë, Pse e mashtroni vetveten?, Islami: Feja e Lehtësisë, Përkushtimit dhe Entuziazmit të përshkruar në Kuran, Të parët e të Mirës në Çdo gjë, Si e interpretojnë të paditurit Kurantin?, Disa fshehtësi të Kuranit, Guximi i besimtarëve, Të qenit optimist në Kuran, Drejtësia dhe Toleranca në Kuran, Parimet themelore të Islamit, Ata që nuk ia vënë veshin Kuranit, Marrja e Kuranit si udhërrëfyes, Kërcënimi i fshehtë: Pavëmendshmëria, Singjeriteti i përshkruar në Kuran, Feja e adhurimit të njerëzve, Metodat e gënjeshtarit në Kuran.

PËR LEXUESIN

Arsyeja pse është caktuar një kapitull i posaçëm për rënien e teorisë së evolucionit është se kjo teori përbën bazën e të gjitha filozofive anti-shpirtërore. Pasi që Darwinizmi refuzon faktin e krijimit dhe si pasojë ekzistencën e Allahut, gjatë 140 viteve të fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre dhe të bien në mosbesim. Prandaj, të tregohet se kjo teori është një mashtrim është detyrë shumë e rëndësishme, e cila është fuqishëm e lidhur me fenë. Është imperativ që ky shërbim i rëndësishëm t'i bëhet çdokujt. Disa prej lexuesve tonë mund të kenë mundësinë të lexojnë vetëm njërin prej librave tonë. Prandaj, e shohim si të përshtatshme t'ia kushtojmë një kapitull përmbledhjes në lidhje me këtë çështje.

Në të gjithë librat e këtij autori, çështjet e lidhura me besimin shpjegohen në dritën e vargjeve Kuranore dhe njerëzit thirren t'i mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në harmoni me to. Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut shpjegohen në atë mënyrë për të mos lënë hapësirë për dyshim apo pikëpyetje në mendjen e lexuesve. Stili i çiltër, i qartë dhe i rrjedhshëm i përdorur siguron që secili person i secilës moshë dhe nga çdo kategori e shoqërisë të mund t'i kuptojë me lehtësi këta libra. Ky rrëfim efikas dhe i qartë mundëson që ato të lexohen përnjëherësh. Madje edhe ata që me ashpërsi refuzojnë natyrën shpirtërore ndikohen nga faktet e rrëfyera në këta libra dhe nuk mund ta refuzojnë vërtetësinë e përmbytjes së tyre.

Ky libër dhe të gjitha veprat e Harun Jahjasë mund të lexohen individualisht apo të diskutohen në grup. Ata lexues që kanë dëshirë të përfitojnë prej këtyre librave do ta shohin se diskutimi për to është shumë i dobishëm, sepse do të jenë në gjendje t'i rrëfejnë njëri tjetrit mendimet dhe përvojat e tyre.

Veç kësaj, është një shërbim i madh për fenë të kontribuohet në prezantimin dhe qarkullimin e këtyre librave, të cilët janë shkruar vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës, kështu, për ata që dëshirojnë t'ua komunikojnë fenë njerëzve, njëra prej metodave më efektive është t'i inkurajojnë ata t'i lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të gjejë pak kohë për t'i hedhur një shikim pasqyrës së librave tjerë në faqet e fundit të librit dhe të vlerësojë burimin e pasur të materialit mbi çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë shumë të dobishme dhe është kënaqësi t'i lexosh. Në to, njeriu nuk do të gjejë, sikurse në disa prej librave të tjerë, pikëpamjet personale të autorit, shpjegime të bazuara në burime të dyshimta, stile të pavëmendshme ndaj respektit dhe nderimit që u takon çështjeve të shenjta, ose shpjegime të pashpresë, që ngjallin dyshime dhe shpjegime pesimiste që krijojnë devijime në zemër.

CONTENTS

Parathënie

- 8 -

Historia e Profetëve

- 14 -

Fëmijëria e Profetit Jusuf (as)

- 26 -

Jeta e re e Profetit Jusuf (as)

- 49 -

Ditët e Jusufit (as) në burg

- 69 -

Koha e Jusufit (as) si Guvernator i Egjiptit

- 86 -

Endrra Profetit Jusuf (as) Realizohet

-115 -

Prëfundim

-120 -

Mashtrimi I Evolucionit

- 124 -

PARATHËNIE

Kurani iu zbrit njerëzimit nga Allahu që t'i shërbej si udhërrëfyes, ai përmban të dhënat më të sakta, që i sjellin lajme të gëzuara njerëzimit, që e paralajmërojnë atë dhe e rrënjosin frikën në të. Është një mëshirë e madhe dhe i vetmi Libër Hyjnor. Për atë arsye, njerëzit duhet ta lexojnë dhe mësojnë Kurandin mbi çdo gjë tjetër.

Sikur që përmban urdhërat e Allahut, Kurani gjithashtu u jap njerëzve të dhënat më të sakta për një varg çështjesh.

Allahu na mëson urtësi të rëndësishme në ato pjesë ku përshkruhen jetët e profetëve të së kaluarës. Tregimi jetësor i secilit profet na pajisë si me mësim të fesë ashtu edhe me shembuj se si duhet të sillemi në kohën dhe shoqërinë në të cilën jetojmë. Mësimi i këtyre tregimeve jetësore në hollësi, përpjekja për të kuptuar urtësinë që ato përmbajnë dhe të luturit Allahut që të mund ta bëjmë këtë, është detyrë e secilit Mysliman.

Në këtë libër do të analizojmë jetën dhe përpjekjet e njërit prej këtyre profetëve të së kaluarës, Jusufit (as), dhe do të marrim

parasysh dijeninë që Allahu na dhuron në lidhje me të.

Profeti Jusuf (as), i njohur në Bibël si Jozefi, është njëri prej atyre profetëve për jetën e të cilit Kurani ka shumë për të thënë. Gati e tërë Surja Jusuf, njëra prej më të gjatave në Kuran, i kushtohet jetës së tij dhe të familjes së tij. Herët në këtë sure, Allahu zbulon se tregimi i tij jetësor përmban informata të rëndësishme, dëshmi dhe urtësi:

Njëmend, për ata që pyesin (interesohe), në ndodhinë e Jusufit dhe të vëllezërve të tij pati fakte (mbi fuqinë e Zotit). (Sure Jusuf: 7)

Pasi që Allahu u kushton shumë hapësirë hollësive të jetës së Profetit Jusuf (as), mund të jemi të sigurt se besimtarët mund të mësojnë shumë prej saj. Në të vërtetë, vargjet e fundit të sures theksojnë se tregimet jetësore të profetëve përmbajnë mësim të rëndësishme për ata që posedojnë mençuri dhe arsye dhe që janë në gjendje të kuptojnë kuptimet thelbësore të pranishme në krijim:

Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim të përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson. (Sure Jusuf: 111)

Njëri prej shembujve më madhështor të urtësisë në

tregimet jetësore të profetëve është mënyra se si vargjet jo vetëm që përshkruajnë ngjarjet në të kaluarën, por gjithashtu ofrojnë mësim për gjeneratat e ardhshme duke vënë theksin në ndodhitë që akoma duhet të ndodhin. Në këtë kuptim, jeta e Jusufit (as) ka disa domethënie. Kur i hedhim një vështrim jetës së tij shohim se Myslimanët janë përballur me vështirësi të ngjashme në të gjitha kohërat, se ata u janë nënshtruar akuzave të pabaza prej njerëzve që nuk janë të fesë së tyre dhe se ata kanë përjetuar situata të shumta në të cilat është dashur të tregojnë durim dhe bindje përballë vullnetit të Allahut. Na është thënë se në një moshë të re Profeti Jusuf (as) ishte hedhur në një pus nga vëllezërit e tij dhe ishte lënë të vdes, se ai më vonë ishte shitur si rob dhe kishte kaluar shumë vite në burg si pasojë e akuzave të rrejshme dhe se ishte sprovuar me një varg vështirësish. Pra kur besimtarët i hedhin një vështrim jetës së tij gjejnë një numër të madh ngjashmëri me vet jetët e tyre. Është ligji i pandryshueshëm i Allahut ai që besimtarët gjatë gjithë kohës janë përballur me situata të ngjashme. Allahu e bën të qartë këtë në një numër të vargjeve:

Ky është ligji i Tij edhe me të dërguarit që i dërgoi para teje. E në ligjin Tonë ti nuk gjen ndryshim. (Sure Isra: 77)

(ky është) Ligji i Allahut e është i kahershëm edhe ndër të parët, në ligjin e Allahut nuk do të gjesh ndryshime. (Sure Fet'h: 23)

Veç kësaj, pas gjithë kurtheve që iu kurdisën atij; mënyra se si ai u hodh në pus, si u përgojua, si u burgos padrejtësisht dhe



u la aty me vite, Allahu më në fund e bëri Jusufin (as) drejtues të Thesarit të Shtetit. Ai i dha atij pushtet, pozitë dhe pasuri. Ligji i pandryshueshëm i Allahut vlen këtu, sikur që vlen në çdo sferë tjetër. Allahu premton në disa vargje se besimtarët do të jenë të shpëtuar pas gjithë fatkeqësive të tyre:

Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira Allahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e

***pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës
Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë
Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe
pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishu-
rit. (Sure Nur: 55)***

Pikërisht si edhe me profetët tjerë, besimtarët që lexojnë tregimin jetësor të Profetit Jusuf (as) do të ndeshen me shumë lajme të gëzuara dhe do të mësojnë një numër të madh mësimesh. Duke qenë kështu, secili besimtar duhet t'i lexojë këto histori dhe të përpiqet ta kuptojë urtësinë që ato përmbajnë. Të kuptuarit e plotë të jetës së Profetit Jusuf (as) do t'i pajisë besimtarët me atë lloj diturie që do t'iu sjellë dobi atyre në jetën e tyre të përditshme dhe gjatë gjithë jetës së tyre.



HISTORIA E PROFETËVE

Kur e analizojmë historinë e profetëve, ndeshemi me një të vërtetë mahnitëse. Numri më i madh i tyre kishin prejardhje të njëjtë. Kjo zbulohet në një numër vargjesh në Kuran

Këta (të përmendur) ishin që Allahu i gradoi nga pejgamberët pasardhës të Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Jakubit (Israilët), dhe prej atyre që i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur... (Sure Merjem:58)

Siç mund të shihet prej këtij vargu, individët superior të cilët u dërguan si profetë u zgjodhën posaçërisht prej Allahut dhe bënë thirrje në emër të Tij për në rrugën e drejtë. Natyrisht se është një nder i jashtëzakonshëm të jesh i zgjedhur i Allahut. Prandaj profetët janë individë shumë të vlefshëm, si për arsye se u zgjodhën prej Allahut ashtu edhe për shkak të natyrës së drejtë të tyre.

Pas profetit të parë, Ademit (as), profeti më i vjetër i përmendur në Kuran është Nuhi (as). Siç e dimë, Nuhi (as) tregoi durim dhe vendosmëri të madhe në shpjegimin e qenies dhe njëshmërisë së Allahut një fisi mosbesimtar dhe kur ai fis këmbënguli në mohimin e tyre, ata u fundosën nga një rrebesh i madh shiu që e dërgoi Allahu. Vetëm Nuhi (as) dhe ata besimtarë që e pasuan atë shpëtuan, duke e mbijetuar rrebeshin me anë të arkës që kishin ndërtuar, ashtu siç u kishte premtuar Allahu.

Allahu lavdëron Profetin Nuh (as) në Kuran:

Selam i qoftë Nuhut (prej Allahut e prej krijesave) në mbarë botën (si kujtim ndaj tij). Ne kështu i shpërblejmë të mirët. Vërtet, ai ishte prej robërve Tonë që janë besimtarë. (Sure Saffat:79-81)

Në një varg tjetër Allahu zbulon se pasardhësit e Profetit Nuh (as) do të jenë “të qëndrueshëm,” me fjalë të tjera se ata kurrë nuk do të zhduken:

Për Zotin Neve na pat thirr në ndihmë Nuhu, Ne jemi përgjegjës të mirë. Dhe Ne e shpëtuan atë dhe familjen e tij prej asaj të keqe të madhe.

E pasardhësit e tij i bëmë ata që vazhduan jetën. (Sure Saffat: 75-77)

Gjeneratat erdhën e shkuan pas Profetit Nuh (as) dhe njerëzit papë u larguan nga rruga e drejtë, duke i adhuruar idhujt

dhe duke ia kthyer shpinën Allahut. Në atë kohë, Profetit Ibrahim (as) iu dhurua dhuntia e profecisë (pejgamberllëkut) dhe iu dha përgjegjësia që të thërriste njerëzit që t'i kthehen Allahut dhe rrugës së drejtë. Profeti Ibrahim (as) ishte njëri prej pasardhësve të Profetit Nuh (as) që kishin mbetur “të qëndrueshëm” në tokë. Allahu e zbulon këtë në Kuran me këto fjalë:

Edhe Ibrahim i ishte i grupit të tij. (Sure Saffat: 83)

Profeti Ibrahim (as) ishte një njeri shumë i dëlirë dhe i shenjtë dhe njeri që Allahu e lavdëroi. Në një varg, Allahu pohon:

Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është bindur Allahut dhe, duke qenë bamirës, e ndjek fenë e drejtë të Ibrahimit? Allahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin më të ngushtë. (Sure Nisa: 125)

Veç kësaj siç zbulohet në Kuran në lidhje me Profetin Ibrahim (as):

• Vërtet, Ibrahim i ishte shumë i butë, shumë i dhembshëm dhe i kthyeshëm. (Sure Hud: 75)

• Vërtet, Ibrahim ka qenë shëmbëlltyrë e të mirave, adhurues i Allahut, besimtar i drejtë dhe nuk ka qenë nga idhujtarët. (Sure Nahl: 120)

- ***Falënderues për të mirat e Tij. Ai (Allahu) e zgjodhi atë (për pejgamber) dhe e udhëzoi në rrugën e drejtë. (Sure Nahl: 121)***
- ***A u kanë zili atyre njerëzve për atë që Allahu u dha nga mirësitë e Tij? Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit Librin e Urtësinë (Sheriatin) dhe u patëm dhënë atyre pushtet të madh. (Sure Nisa: 54)***
- ***E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuan Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. (Sure En'am: 84)***
- ***Dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet (Sure Nexhm: 37)***

Me Profetin Ibrahim (as) filloi një brez i pandërprerë i pasardhësve. Edhe pse ai kreu detyrën e tij si i dërguar te mohuesit e Allahut me sinqeritet dhe vendosmëri të madhe, shumica e njerëzve përreth tij (me përjashtim të kushëririt të tij, Profetit Lut (as)) dështuan t'i kushtojnë vëmendje porosisë së tij. Në këtë moment, Profeti Ibrahim (as) kërkoi prej Allahut që një besimtar i pastër të jetë trashëgimtar i tij dhe të vazhdoj të përfaqësoj fenë e Allahut në tokë. Allahu iu përgjigj lutjes së Profetit Ibrahim (as) me një mrekulli, duke i dhënë gruas së tij një fëmijë të pastër, megjithëse ajo ishte e vjetër dhe shterpë. Në këtë mënyrë Profeti Ibrahim (as) u bë babai i Profetit Is-hak (as), i cili ishte një profet i

shquar në sytë e Allahut, i pajisur me arsye, besim dhe vetëdije për Zotin. Me kohë, Profeti Is-hak (as) gjithashtu pat një djalë dhe e quajti Jakub. Që të dy ishin dhunti të Allahut për Profetin Ibrahim (as):

E pasi u largua prej tyre dhe prej çka adhurorin ata pos Allahut, Ne i dhuruam atij Is-hakun dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë peygamberë. (Sure Merjem: 49)

Dhe Ne i dhuruam atij Is-hakun dhe Jakubin, e në pasardhësit e tij shpallëm peygamberllëkun dhe librin e shenjtë (librat e shpallura), atij i dhamë shpërblimin në këtë botë, kurse në botën tjetër do të jetë ndër të mirët e përsosur. (Sure Ankebut: 27)

Një djalë tjetër i Profetit Ibrahim (as) ishte Profeti Ismail (as). Së bashku ata ndërtuan “shtëpinë” e parë, ose vendin e adhurimit, Qaben. Lutja që ata bënë në këtë kohë është shënuar në Kuran me këto fjalë:


Edhe kur Ibrahim i dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes - luteshin): "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!"

Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të

bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtetë Ti je që falë, je mëshirues!" (Sure Bekare: 127-128)

Allahu iu përgjigj kësaj lutje dhe prej pasardhësve të Profetit Ibrahim (as) krijoi një bashkësi që i nënshtrohej Allahut plotësisht. Bijtë dhe nipat e Profetit Ibrahim (as) dhe vet fëmijët e tyre ishin njerëz të bekuar që në mesin e tyre kishin profetë, që besuan në Allahun dhe jetuan në pajtim me urdhërat e Tij përkundër faktit se jetuan në një mjedis kryesisht pagan. Profeti Musa (as), Haruni (as), Davudi (as), Sulejmani (as), Jakubi (as) dhe Junusi (as) dhe shumë të tjerë si ata ishin të gjithë individë të pastër dhe të përsosur, pasardhës të Profetit Ibrahim (as). Allahu thotë kështu për pasardhësit e profetëve:

Ne atij (Ibrahimit) i falëm Is-hakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuam. Më parë edhe Nuhun e patëm udhëzuar. E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë bamirësit. (shpërblyem) Edhe Zekerijanë, Jahjanë, Isain, Ilijasin të gjithë prej të mirëve të përsosur. (shpërblyem) Edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këta i veçuam mbi njerëzit tjerë. Edhe disa nga prindërit, nga pasardhësit dhe nga vëllezërit e



Many verses in the Qur'an speak of the Prophet Ibrahim (as), the Prophet Ya'qub (as) and the Prophet Yusuf (as). Sura 14 bears the name 'Ibrahim,' and Sura 12 "Yusuf."

tyre i zgjodhëm (për pejgamberë) dhe i udhëzuar në rrugë të vërtetë. Ky është udhëzim i Allahut, udhëzon me të kë të dojë nga robërit e Tij. E sikur t'i përshkruajnë shok Zotit (edhe ndonjë nga këta) kishte për t'iu shkuar huq ajo që kanë vepruar. Ata ishin që u patëm dhënë librin, urtësinë e pejgamberllëkun; e nëse këta (idhujtarët mekas) e refuzojnë këtë (pejgamberllëkun tënd), Ne e kemi siguruar këtë me një popull që nuk e refuzon. Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që All-llahu i vuri në rrugë të drejtë... (Sure En'am: 84-90)

Profeti Ibrahim (as) ua kaloi besimet e tij djemve të tij, një proces ky që u përsërit nga nipi i tij Jakubi (as). Allahu përshkruan këtë në Kuran:

Kur Zoti i vet i tha atij: "Dorëzohu"! Ai tha: "Iu kam dorëzuar Zotit të gjithësisë"! E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi, (u tha) "O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë!" A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: "Çka do të adhuron pas meje"? Ata thanë: "Do të adhurojmë Zotin tënd, dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, një të vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar!"

Ai ishte një popull që kaloi, atij i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat, prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që vepruan ata. (Sure Bekare: 131-134)

Mirëpo, të jesh pasardhës i Profetit Ibrahim (as) sigurisht që nuk domethënë se do të jetë i drejtuar automatikisht në rrugën e drejtë. Njësoj sikur që ky brez ka përfshirë profetë, njerëz të devotshëm dhe që i frikësohen Zotit, po ashtu ka nxjerrë njerëz që nuk kanë arritur të kuptojnë konceptin e fesë apo të gjejnë rrugën e drejtë. Ky fakt zbulohet po ashtu në Kuran. Duke folur, për shembull, për pasardhësit e Profetit Ibrahim (as) dhe të djalit të tij Profetit Is-hak (as), Allahu thotë:

Dhe Ne i dhuruan bekim atij dhe Is-hakut e

prej pasardhësve të atyre dyve do të kenë punëmirë e të ndershëm, e edhe dëmtues të hapët të vetvetes. (Saffat: 113)

Natyrisht, profetët ishin njerëz të zgjedhur, njerëz superior, por siç do të shohim në kapitujt në vazhdim, në mesin e nipave të tyre, vëllezërve, djemve, baballarëve dhe madje edhe grave të tyre, dolën njerëz që u sollën në kundërshtim me vullnetin e Allahut, tejkaluan kufijtë që përcaktoi Ai dhe kundërshtuan fenë e Tij. Allahu zbulon këtë në një varg tjetër:

Ne Nuhun dhe Ibrahimin i zgjodhëm të dërguar e pasardhësve të atyre dyve ua dhamë pe-jgamberllëkun dhe Librin. Disa prej tyre i udhëzuan në rrugë të drejtë po shumë prej tyre mbetën jashtë rrugës. (Sure Hadid: 26)

Në mesin e atyre që u sollën në këtë mënyrë përkundër asaj se ishin pasardhës të profetëve ishin disa prej djemve të Profetit Jakub (as).

Allahu flet për Profetin Jakub (as) shumë herë në Kuran, duke e përshkruar atë si njeri të sinqertë, të vendosur, largpamës, të zgjedhur dhe të favorizuar. Allahu flet për cilësitë e larta të Profetit Jakub (as), në këto vargje:

Përkujto robërit tanë Ibrahimin, Is-hakun, Jakubin që ishin të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës në fe. Ne i pajisëm ata me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës

tjetër. S'ka dyshim se ata ishin te Ne prej të zgjedhurve më të mirë. (Sure Sad: 45-47)

Dhe ia falën atij Is-hakun, e si dhuratë edhe Jakubin. Dhe që të gjithë i bëmë të mirë (pejgamberë). Dhe ata i bëmë shëmbëlltyrë që udhëzonin sipas urdhrit Tonë, i orientuam në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zeqatit, dhe ata ishin adhures Tanë të sinqertë. (Sure Enbija: 72-73)

Veç kësaj, Allahu gjithashtu zbulon në Suren Jusuf se Profeti Jakub (as) ishte një njeri i ditur, i cili posedonte dituri të posaçme që i ishte dhuruar atij:

Po ai (Jakubi) ishte i dijshtëm për te, ngase Ne e kemi mësuar për atë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Sure Jusuf: 68)

...Ai(Jakubi) tha: "A nuk ju thashë se unë di nga All-llahu çka ju nuk dini?" (Sure Jusuf: 96)

Njëri prej djemve të Profetit Jakub (as) ishte Profeti Jusuf (as), i cili më së miri kuptoj besimin dhe virtytet morale që Jakubi (as) i inkurajoi tek fëmijët e tij. Këtë mund ta shohim prej fjalëve të tij siç na rrëfen Allahu në Kuran:

Unë e ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is-hakut, Jakubit. Neve nuk na takoi t'i për-

shkruajmë kurrë një send shok Allahut. Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe nga Allahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën. (Sure Jusuf: 38)

Megjithatë, nuk ishin të gjithë vëllezërit e Jusufit sikurse ai. Përveç vëllait të tij më të ri, i cili i përngjante shumë atij, vëllezërit e tjerë të tij nuk arritën të kuptojnë konceptin e besimit, ishin robër të dëshirave të tyre vetjake dhe tejkalan kufijtë që Allahu përcaktoi. Prandaj, këta vëllezër ishin ata që ia përgatitën një kurth mizor Profetit Jusuf (as).

Kapitujt në vazhdim të këtij libri do të përshkruajnë këtë kurth që u përgatit për Profetin Jusuf (as), çfarë ndodhi pastaj dhe sjelljen e tij shembullore përballë gjithë këtyre ngjarjeve.



FËMIJËRIA E PROFETIT JUSUF (as)

ËNDRRA E TIJ E FËMIJËRISË

Profeti Jusuf (as) pa një ëndërr kur ishte ende fëmijë dhe e pyeti babanë e tij se çfarë kuptimi kishte ajo. Babai i tij, Profeti Jakub (as), interpretoi ëndrrën dhe e përgëzoi atë. Ai po ashtu e paralajmëroi Jusufin (as) që të mos u tregonte vëllezërve të tij për të. Kjo ngjarje përshkruhet në Kuran:

(përkujto) Kur Jusufi, babait të vet i tha: "O baba im, unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!"

Ai (Jakubi) tha: "O biri im, mos u trego ëndrrën tënde vëllezërve tu, se po të bëjnë ndonjë dredhi, s'ka dyshim, djalli për njeriun është armik i hapët".

Ja, kështu Zoti yt të zgjedh ty, të mëson interpretimin e ëndrrave, plotëson dhuntinë e Tij ndaj teje dhe familjes së Jakubit, sikurse pat plotësuar atë më parë ndaj prindërve tu, Ibrahimit dhe Is-hakut. Vërtet, Zoti yt është më i dijshtëmi, më i urti!" (Sure Jusuf: 4-6)

Arsyeja pse babai i tij paralajmëroi Jusufin (as) që të mos u tregonte vëllezërve të tij për ëndrrën qëndron në sjelljen e tyre, e cila nuk arriti të frymëzojë çfarëdo sigurie. Si një njeri i urtë dhe i kuptueshëm, Profeti Jakub (as) ishte i vetëdijshtëm se djemtë e tij kishin karakter të tillë që ngjallte grindje dhe xhelozë. Duke i njohur ata aq mirë, atij ia mori mendja se ata mund t'i përgatitnin ndonjë kurth Jusufit (as). Për këtë arsye Profeti Jakub (as) paralajmëroi Jusufin (as) për armiqësinë e shejtanit dhe e këshilloi atë që të jetë i kujdesshëm.

Mësimi që duhet të nxjerrim nga kjo është se Myslimanët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj njerëzve që shkaktojnë përçarje dhe ngatërresa dhe ndaj njerëzve që janë të dobët në çështjet e fesë dhe të mos u tregojnë njerëzve të tillë për zhvillimet e kënaqshme ose gjasat e mira të ardhshme për Myslimanët. Kjo për arsye se njerëzit që janë vërtet të devotshëm kënaqen kur Myslimanëve u ndodhë ndonjë e mirë, bëhen më të fuqishëm apo në përgjithësi vijjnë në pozitë të favorshme, ndërsa ata që shkaktojnë përçarje tmerrësisht pikëllohen nga kjo. Pasi që të tillët nuk kanë dëshirë të shohin çka do që i sjellë dobi fesë apo besimtarëve të saj, ata përpiqen që të parandalojnë që të ndodhin gjëra të tilla dhe madje bashkëpunojnë me armiqtë e besimtarëve në mënyrë që të ndodhë



Prophet Yusuf (as) dreamt of 11 stars, the sun and moon prostrating themselves before him. The illustration shows a representation of this.

kjo. Allahu përshkruan sjelljen e ngatërrestarëve:

Nëse ty të takon ndonjë e mirë (në luftë), ajo u vjen keq atyre, e nëse të godet ndonjë e pakëndshme, ata thonë: "Ne edhe më parë kemi ndërmarrë për çështjen tonë dhe kthehen të gëzuar. (Sure Teube: 50)

Për këtë arsye njerëzve të tillë nuk duhet t'u tregohet për zhvillimet e kënaqshme dhe të mbara në lidhje me Myslimanët para se ato të ndodhin dhe për këtë arsye ndaj të tillëve duhet të sillemi me kujdes të madh. Paralajmërimi që Profeti Jakub (as) i bëri djalit të tij Jusufit (as) është një shembull i qartë për këtë.

KURTHI I PËRGATITUR PËR PROFETIN JUSUF (AS) PREJ VËLLEZËRVE TË TIJ

Profeti Jakub (as) kishte të drejtë kur paralajmëroi djalin e tij. Vëllezërit tjerë ishin xheloz në të dhe në vëllain e tij më të ri. Kjo zili digjej me aq forcë përbrenda tyre sa që i shtyri ata të për-

gatitin kurth për Jusufin (as). Ky është edhe një tregues tjetër se sjellja e vëllezërve të Jusufit ishte shumë larg vlerave morale të Islamit dhe se ata po dështonin të shfaqnin karakterin e besimtarëve të vërtetë. Kurthi që ata përgatitën dhe ajo që ata i bënë Profetit Jusuf (as) rrëfohen në Kuran:

Kur ata (vëllezërit) thanë: "Pasha Zotin, Jusufi dhe vëllai i tij, janë më të dashur te baba ynë se sa ne, ndërsa ne jemi grup (i fortë). Vërtet, babai ynë është në gabim sheshazi. Mbyteni Jusufin ose hidheni diku larg në një vend e babai juaj t'ju dojë juve e pas asaj (pendohuni) bëheni njerëz të mirë. (Sure Jusuf: 8-9)

Siç duket fare qartë në këto vargje, zilia ishte arsyeja kryesore që qëndronte prapa kurthit që vëllezërit e Jusufit përgatitën për të. Mendimi se babai i tyre e donte Jusufin (as) dhe vëllain e tij më shumë ishte ajo që i çoj ata drejt kësaj xhelozie. Ata dëshironin një dashuri të drejtuar vetëm nga ata, dhe menduan, për shkak të numrit të tyre dhe mënyrës se si i jepnin zemër njëri tjetrit, se ata kishin më shumë të drejtë në atë dashuri.

Është e qartë se kjo është mënyra më e shtrembëruar e të menduarit. Sipas Kuranit, masa e vërtetë e dashurisë së një besimtari është se deri në çmasë është e motivuar ajo nga vetëdija për Zotin. Kushdo që është më se i vetëdijshëm për Allahun më së shumti i frikësohet Atij dhe qëndron me përpikëri përbrenda kufijve të sjelljes të përcaktuar prej Tij. Prandaj, njerëzit që ata duan më së shumti janë ata që shfaqin vlerat më të drejta morale. Ky është kuptimi i dashurisë i besimtarëve. Është e qartë se Profeti Jakub

(as) përvetësoi këtë masë të njëjtë kur iu dha dashurinë djemve të tij. Është plotësisht e natyrshme se pasi që Profeti Jusuf (as) ndjente më shumë frikërespekt ndaj Zotit dhe posedonte vlera më të larta morale se vëllezërit e tjerë të tij ai duhej ta kishte dashur atë më së shumti. Mirëpo, pasi që vëllezërit e Profetit Jusuf (as) nuk ndanin atë pikëpamje, ata nuk ishin në gjendje të kuptojnë dashurinë që babai i tyre ndjente për Jusufin (as) dhe për vëllain e tyre më të ri. Ky është një tregues i rëndësishëm i asaj se sa shumë kishin devijuar karakteret e tyre nga feja e tyre.

Një aspekt tjetër i sjelljes së tyre që vlen të përmendet është mënyra e pasjellshme me të cilën ata u sollën ndaj babait të tyre. Përkundër asaj se babai i tyre ishte profet i zgjedhur dhe njeri me zgjuarsia dhe arsye të lartë, ata pretendonin se babai i tyre “po gabonte haptazi” për shkak të dashurisë së tij ndaj Jusufit (as) dhe vëllait të tij. Kjo sjellje e paturpshme ndaj një profeti tregon se sa i dobët ishte besimi i tyre. Veç kësaj, mënyra se si ata u përpoqën ta mbysin Profetin Jusuf (as) është edhe një dëshmi e dobësisë së besimit të tyre dhe e natyrës së tyre ngatërrestare. Është fare e qartë se asnjë njeri që i frikësohet Allahut, që beson se do të jap përgjegjësi për veprimet e tij në jetën e përtejme (në ahiret) dhe që e di se Allahu e sheh dhe e dëgjon atë në çdo çast asnjëherë nuk do të mund të përkrahte ndërmarrjen e një veprimi të tillë dhe madje kurrë as që do të mund ta mendonte një gjë të tillë as edhe për një moment të vetëm. Mirëpo, për ta bërë babën e tyre që t’i don apo t’i kënaqë ndjenjat e tyre të xhelozisë, këta njerëz besuan se zgjidhja ishte ta mbysin Profetin Jusuf (as) apo ta braktisin atë diku në rrugë.

Vrasja është gjithsesi një mëkat dhe braktisja e një fëmije



A painting of the Prophet Ya'qub (as) and his children. The main motivation behind the trap his brothers set for Prophet Yusuf (as) was jealousy. It was the fact that they believed that their father loved Yusuf (as) and his brother more than he did them that spurred this jealousy.

të ri buzë rrugës është një veprim shumë i lig. Njerëzit të cilët madje do të mendonin të bëjnë një gjë të tillë është e qartë se nuk kanë vetëdije apo ndjenjë keqardhjeje. Prandaj, vëllezërit e Profetit Jusuf (as) ishin të pandjenja dhe të pamëshirë.

Mënyra e të menduarit të tyre ishte po ashtu plotësisht e gjymtë. Ata shpresuan se pas kryerjes së një mëkati të tillë dhe pas bërjes së një gjëje kaq të lig ndaj Jusufit (as) mund të mbeteshin ende prej atyre “që veprojnë drejt.” Natyrisht se nëse dikush me të vërtetë dëshiron që Allahu ta falë atë pasi të ketë bërë mëkat ai po ashtu mund të shpresoj që të ndryshojë sjelljen e tij dhe të jetë prej atyre që ndejnë frikërespekt ndaj Zotit. Megjithatë, këta burra shpresuan të mbeten prej atyre që ndejnë frikërespekt ndaj Zotit edhe duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se veprimet e tyre ishin

të gabueshme. Kjo është edhe një dëshmi tjetër se atyre u mungonte aftësia e të gjykuarit dhe karakteri i besimtarit të vërtetë.

Kjo mund të shihet në vazhdim të këtij vargu se në momente të rrezikut të skajshëm Allahu ndihmoi Profetin Jusuf (as), duke i frymëzuar vëllezërit e tij që ta hedhin atë në pus në vend se ta mbysin

Njëri prej tyre tha: "Mos e mbytni Jusufin, e në qoftë se jeni për të bërë diç, lëshojeni atë në fund të bunarit, do ta marrë atë dikush prej udhëtarëve". (Sure Jusuf: 10)

Siç kemi parë, pa marrë parasysh se çfarë plane sajuan ata në lidhje me Profetin Jusuf (as) dhe pa marrë parasysh se çfarë kurthe kurdisën për të, profeti ishte gjithnjë i nënshtruar ndaj fatit që Allahu kishte përcaktuar për të. Askush kurrë nuk mundet të ndalojë fatin i cili i është ndarë atij. Allahu e ka krijuar fatin e Profetit Jusuf (as) madje para se ai të lindte dhe profeti përjetoi atë fat pikërisht ashtu si e kishte përcaktuar Allahu.

Duhet të jemi të vetëdijshëm në këtë pikë se nuk ishte vëllai ai që i mundësoi Jusufit (as) të mbijetoj duke sugjeruar që ta hedhin atë në pus, por se ishte Allahu Ai që ndaloi vdekjen e tij. Po të kishte dashur Allahu, mund të mos ia kishte dhënë vëllait kurrë idenë që ta hedhin Jusufin (as) në pus. Mirëpo, ishte e shkruar si fat i Profetit Jusuf që ata të planifikonin ta mbysin atë por pastaj në vend të kësaj e hodhën në pus. Ja pse vëllait të tij iu kujtua kjo ide. Mendimi i rëndomtë që dikush mund ta mashtroj fatin e vet është i pamundur. Fati i Profetit Jusuf (as) ishte përcaktuar deri në hol-



Another representation of Prophet Yusuf's brothers. Their jealousy of the Yusuf (as) was so fierce that they were able to ruthlessly throw him into a well, despite his youth.

lësinë më të vogël. Fakti se ata nuk e mbytën atë nuk ishte rezultat i asaj se plani i tyre kishte dështuar, por për shkak se Allahu e kishte planifikuar ndryshe që nga fillimi.

Në të vërtetë, Allahu ia kishte zbuluar këtë plan atij në ëndrrën e tij kur ai ishte ende fëmijë. Jeta e Profetit Jusuf (as) u shpalos në mënyrë të tillë për të vërtetuar vërtetësinë e kësaj ëndrre. Allahu ndonjëherë mund t' u jap disa prej robërve të Tij shenja në lidhje me të ardhmen. Ai i zbuloi Profetit Muhammed (saas) në një ëndërr që ai do të pushtonte Mekën dhe se do të shkonte në pelegrinazh (haxhillëk) me besimtarët në siguri të plotë. Vargu në fjalë lexon:

Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të sigu-

ruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t'i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin). (Sure Fet'h: 27)

Çelësi i të kuptuarit të aftësisë së Allahut për të zbuluar atë që është “e panjohur” deri më sot me ndodhi që ndodhin pikërisht ashtu si i zbuloi Ai, është që të vlerësohet se gjithçka që është e panjohur për ne tashmë ka ndodhur në praninë e përjetshme të Allahut dhe tashmë është kryer dhe ka marrë fund. “E panjohura” vlen për qeniet njerëzore. Është Allahu, i Cili nuk është i kufizuar nga koha dhe hapësira, i Cili krijon dhe din gjithçka. Ai ka krijuar gjithë kohën dhe gjithë historinë si një çast të vetëm.

Ne nuk guxojmë ta harrojmë këtë të vërtetë ndërsa vazhdojmë të shqyrtojmë pjesën tjetër të historisë jetësore të Profetit Jusuf (as). Çdo gjë që ndodhë ndodh në përputhje me vullnetin e Allahut dhe për besimtarët ka dobi në çdo gjë që ndodhë. Pas çdo vështirësie dhe fatkeqësie që kërkon durim, Allahu dhuron mirëqenie dhe mirësi në këtë botë si edhe shpërblim në jetën e përtejme (ahiret). Për atë arsye, ndodhitë që duket të jenë “fatkeqësi” nga ana e jashtme, si për shembull të qenit i robëruar, i futur në burg dhe i përgojuar, janë të gjitha në të vërtetë ndodhi të mbara për besimtarët.

PLANI DINAK I VËLLEZËRVE

Në Kuran, Allahu zbulon se vëllezërit e Profetit Jusuf (as) përgatitën një plan dinak kundër tij, plan të cilin ata pastaj e vunë në veprim. Për ta realizuar planin e tyre ata së pari e pyetën babanë e tyre, Profetin Jakub (as), që ta lejonte Jusufin (as) që të



Prophet Yusuf's brothers around the well they threw him into. They are unaware of what awaits them as they drop him into its depths. However, everything happens according to the fate decreed by Allah.

shkonte së bashku me ta dhe pastaj filluan ta bindin atë, megjithëse ishin të vetëdijshëm se ai nuk u besonte atyre :


Ata thanë: "O baba ynë ç'ke që nuk na beson për Jusufin, e ne ia duam të mirën atij? Dërgoje nesër atë me ne, le të hajë pemë dhe le të luajë me siguri do ta ruajmë atë. (Sure Jusuf: 11-12)

Siç mund të shihet prej mënyrës se si është shprehur ky varg, babai i tyre ngurronte ta dërgonte Profetin Jusuf (as) së

bashku me ta dhe madje u lejoi atyre që të ndjejnë mungesën e besimit të tij në ta, duke i vënë ata menjëherë në pozitë për t'u mbrojtur. Ata pohonin se dëshironin vetëm atë që ishte e mirë për Jusufin (as). Arsyeja se ata ishin në gjendje ta thonë një gënjeshtër të tillë me aq lehtësi gjersa po përgatiteshin ta mbysin apo ta braktisin atë duke e hedhur në pus, është dëshmi se ngatërrestarët nuk e kanë të vështirë të gënjejnë. Në të vërtetë, ata vazhduan të gënjejnë, duke thënë se dëshironin që Jusufi (as) t'i shoqëronte ata për kënaqësinë e tij. Ata gjithashtu premtuan ta mbrojnë dhe të kujdesen për të. Edhe një çështje tjetër e cila meriton t'i kushtohet vëmendje e veçantë këtu është mënyra se si ngatërrestarët gjithnjë provojnë ta paraqesin veten si qëllimmirë. Mënyra se si ata pohuan se dëshironin atë që ishte më e mira për Jusufin (as), duke lënë përshtypjen se po mendonin vetëm për të mirën e tij, ishte pjesë e natyrës së tyre dinake. Sidoqoftë, Profeti Jakub (as) ishte një person mendjehollë dhe i urtë dhe qartë mund të kuptonte natyrën e dyshimtë të tyre:

Ai tha: "Unë mallëngjehem po të vijë me ju, e edhe kam frikë se do ta hajë ujku, kur mungon kujdesi juaj për të". Ata thanë: "Për Zotin, nëse e ha ujku, duke qenë ne grup kaq i fortë, atëherë ne mos qofshim fare!" (Sure Jusuf: 13-14)

Arsyeja pse Profeti Jakub (as) nuk u besonte djemve të tij dhe dyshonte se ata mund t'i shkaktonin ndonjë të keqe Jusufit (as) e shtyri atë që të shfaqte këto dyshime. Atij ia mori mendja se ata do të mund t'i bënin ndonjë të keqe Jusufit (as) dhe pastaj të ktheheshin tek ai pasi të kishin përgatitur ndonjë mënyrë shfa-



In this painting can be seen Prophet Yusuf's brothers telling their father Ya'qub (as) that a wolf had eaten Yusuf (as) and showing him a bloody shirt as false evidence.

jësimi. Ata kundërshtuan këtë ide me forcë dhe u përpoqën që ta bindin atë se asgjë e tillë nuk do të ndodhte. Kjo është një teknikë tjetër që shpesh përdorin njerëzit me karakter ngatërrestar. Në të vërtetë, josinqeriteti i tyre shfaqet në pjesën tjetër të tregimit prej fjalëve që ata thanë:

***E në mbrëmje erdhën duke qarë te babai i tyre.
Thanë: "O baba ynë, ne shkuam të bëjmë gara,
e Jusufin e lamë te teshat tona edhe atë e kishte
ngrënë ujku. Ti nuk do të na besosh neve, edhe
po të jemi të vërtetë!" (Sure Jusuf: 16-17)***

Siç mund të shihet, rrjedha e ngjarjeve ishte pikërisht ashtu siç kishte menduar Profeti Jakub (as). Sjellja e vëllezërve të



In a film about Yusuf (as), the brothers are shown trying to portray themselves as trustworthy, together with Prophet Yusuf's shirt which they had falsely bloodied.

Jusufit vërtetoi saktësinë e dyshimeve që babai i tyre kishte parandier në lidhje me ta. Fakti se ata erdhën duke qajtur ishte një shenjë e qartë e degjenerimit të sjelljes së tyre. E vërteta është se një qëndrim i tillë i dobët është qëndrim që asnjë besimtar kurrë s'do ta përvetësonte. Pasi që besimtarët e dinë se në çdo gjë ka mirësi dhe mbarësi, ata kurrë as nuk mjerohen dhe as nuk ankohen, pa marrë parasysh se çfarë iu ndodhë atyre.

Veç kësaj, vaji që e bënë vëllezërit e Jusufit ishte i llojit që përdorin ata me karakter jo të sinqertë. Njëra prej teknikave dinake të ngatërrestarëve është përdorimi i lotëve si armë për të mashtruar anën tjetër. Në këtë mënyrë ata përpiqen t'i bëjnë njerëzit tjerë të ndiejnë keqardhje për ta dhe e paraqesin veten si të pafuqishëm. Ata përpiqen që të lënë përshtypjen se meritojnë t'ju besohet ndërsa ata në të vërtetë nuk janë fare të tillë. Ky është një tipar i pandryshueshëm i ngatërrestarëve gjatë shekujve. E vërteta është se vëllezërit e Jusufit nuk ndien as brejtjen më të vogël të ndërgjegjes kur hodhën vëllain e tyre, një fëmijë të vogël, në thel-

lësitë e pusit, mirëpo kur erdh koha që të arsyetoheshin ata erdhën duke qajtur në praninë e babait të tyre. Është e qartë se ata nuk ishin fare të sinqertë dhe lotët e tyre ishin një mashtrim.

Kjo situatë është një mjet për besimtarët që të fitojnë dituri të vlefshme. Kur i kushtohet kujdes i veçantë gënjeshtres që vëllezërit sajuan për Profetin Jusuf (as), shqetësimi i shprehur nga Profeti Jakub (as) është plotësisht i kuptueshëm. Djemtë e tij kishin ardhur me arsytetime, ashtu siç kishte thënë ai vet. Profeti Jakub (as) kishte shprehur qartë shqetësimet e tij në atë që kishte thënë më herët, duke thënë se frikësohej se Jusufin (as) do ta hante ndonjë ujë. Djemtë e tij, besnik ndaj karakterit të ngatërrestarëve, përfshinë këtë shqetësim në gënjeshtren që ia thanë babait të tyre pasi që e hodhën Jusufin (as) në pus. Ata menduan se në këtë mënyrë kishte më shumë mundësi që babai i tyre t'ju besonte. Mësimi që besimtarët duhet të nxjerrin nga ky tregim është që t'i shmangen shprehjes së dyshimeve apo shqetësimeve të sinqerta të tyre në afërsi të ngatërrestarëve. Kjo për arsye se, siç kemi parë në këtë shembull, ata mund t'i shfrytëzojnë fjalët e sinqerta të besimtarëve kundër tyre.

Siç mund të shihet në vazhdim të këtij ajeti, ata në të vërtetë ishin të vetëdijshëm se babai i tyre nuk u kishte besuar. Kjo gjendje rezulton nga një gjendje shpirtërore që vlen jo vetëm për vëllezërit e Profetit Jusuf, por për çdo njeri me karakter të dyfytirëshit. Ata që ngrenë kurthe për besimtarët ndiejnë në vetvete një ndjenjë të përhershme të fajësisë. Ata s'mund të ndalojnë së menduari për veprimet e tyre dhe madje t'i përmendin ato. Ata përdorin konstruksione fjalësh si: "Ti s'do t'na besosh ne kurrë ndonëse ne me të vërtetë po e tregojmë të vërtetën," që asnjë per-

son i ndershëm s' do të përdorte ndonjëherë. Kjo e bën plotësisht të qartë mungesën e tyre të vetëbesimit, që logjikisht buron nga paaftësia e tyre për të shfaqur karakterin dhe vlerat morale të besimtarit. Në Kuran Allahu jap një shembull të mënyrës së të folurit të rrejshëm dhe të ekzagjeruar të ngatërrestarëve:

Kur të erdhën ty hipokritët, të thanë: "Ne dëshmojmë se vërtet ti je i dërguar i Allahut!" E, Allahu e di se ti je i dërguar i Tij, por Allahu dëshmon se hipokritët janë rrenacakë (kur thonë ashtu). Ata betimin e tyre e bëjnë për t'u mbrojtur, andaj ata penguan nga rruga e Allahut. Veprimi që ata bënë është shumë i keq. (Sure Munafikun: 1-2)

Siç kemi parë, një mënyrë e vetëmbrojtjes për ngatërrestarët është të përpiqen "të betohen për t'u mbrojtur," me fjalë tjera të betohen se diçka është e vërtetë ndërsa në të vërtetë ajo është e pavërtetë. Besimtarët, në anën tjetër, u besojnë fjalëve të njëri tjetrit dhe kurrë nuk ndiejnë ndonjë dyshim. Veç kësaj, ngatërrestarët janë të paaftë t'u shkaktojnë çfarëdo dëmi besimtarëve, madje edhe nëse paramendojnë se i kanë mashtruar ata. Allahu përshkruan gjendjen e tyre në këtë varg:

Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes,



The shirt over which Prophet Yusuf's brothers poured false blood and then showed to their father depicted in historical paintings.

por ata nuk e hetojnë. (Sure Bekare: 8-10)

VËLLEZËRIT JAPIN DËSHMI TË RREJSHME

Vëllezërit e Profetit Jusuf ishin, në të vërtetë, plotësisht të vetëdijshëm se ata nuk ishin as edhe një grimë të besueshëm. Për këtë arsye ata sajuan dëshmi të rrejshme, ata po shpresonin se kjo do të mund t'i bënte ata më bindës. Ata lanë këmishën e Jusufit me gjak dhe e sollën te babai i tyre, duke u përpjekur që të krijojnë përshtypjen se ai vërtetë kishte vdekur.

Kjo ndodhi është tregues se ata që kurdisin kurthe për

Myslimanët janë gjithashtu në gjendje që të sajojnë dëshmi të rrejshme për të mbështetur komplotet e tyre. Duke marrë parasysh nevojën për të qenë i vetëdijshëm dhe i përgatitur për metoda të tilla, është e domosdoshme që të shqyrtohet “dëshmia” e paraqitur me shumë kujdes meqenëse Allahu kështu ka urdhëruar:

O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, “shqyrtojeni atë mirë”... (Sure Huxhurat: 6)

Mirëpo, Profeti Jakub (as) refuzoi t’u besoj atyre kategorikisht, e kuptoi se çfarë po përpiqeshin të bënin dhe pohoi se e tërë kjo ishte një gënjeshtër që ata kishin përgatitur:

E erdhën (i sollën) e në këmishën e tij me gjak të rrejshëm. Ai tha: "Jo, (nuk e ka ngrënë ujku), por epsheet tuaja ua hijeshuan punën. ...". (Sure Jusuf: 18)


Duke iu thënë djemve të tij se epsheet e tyre i kishin mashtruar ata dhe i shtynë ata të ndërmarrin veprime të tilla, Profeti Jakub (as) po tërhiqte vëmendjen në faktin se njerëzit mundën me të vërtetë të bëjnë gjëra të tmerrshme nëse ndjekin prirjet e dëshirave të tyre, se dëshirat trupore janë mashtruese dhe se të gjitha të këqijat e tilla burojnë nga shkakut se njerëzit i ndjekin ato dëshira. Ky është një fakt tjetër për të cilin besimtarët duhet ta vrasin mendjen shumë. Dëshirat e kësaj bote i shpien njerëzit nga e liga dhe secili duhet të jetë i vëmendshëm dhe i kujdesshëm gjatë gjithë kohës, të dëgjoj zërin e ndërgjegjes së tij dhe jo atë të epsheve të tij. Veç kësaj, një pjesë tjetër e urtësisë që shfaqet në këtë ajet është se ngatërrestarët nxiten nga epsheet e tyre.

Njëri prej momenteve më mahnitës këtu është sjellja modeste e Profetit Jusuf (as). Kjo sjellje është një shembull i rëndësishëm për mënyrën se si besimtarët duhet ta mbështesin besimin e tyre vetëm në Allahun dhe të kenë guxim, pa marrë parasysh rrethanat me të cilat ndeshen. Siç kemi parë, Profeti Jakub (as) ishte në të vërtetë plotësisht i vetëdijshëm se djemtë e tij kishin ngritur kurth për Jusufin (as). Megjithatë, duke u sjellë me durim dhe përmbajtje të pamasë, ai kërkoi ndihmë prej Allahut. Fjalët që u tha djemve të tij, edhe njëherë zbulojnë se çfarë personi i dureshëm dhe besimtar ishte ai:



"O truthful Yusuf, tell us of seven fat cows which seven thin ones ate and seven green ears of wheat and some others which were dry so that I can return to them and let them know."

(Surah Yusuf: 46)



Prophet Yusuf (as) was thrown into a well by his brothers when he was very young. What is more, it was uncertain whether he could be rescued from the well or not. In spite of this, Prophet Yusuf (as) shows an attitude of great patience and trust in Allah.

...Halli im është: durim i mirë. Allahu është nga i cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju". (Sure Jusuf: 18)

PROFETI JUSUF (AS) HIDHET NË PUS

Ekziston një çështje shumë me rëndësi që nuk duhet harruar kur lexojmë për ndodhitë në jetën e Profetit Jusuf (as) – përderisa përjetonte këto ngjarje ai ishte gjithmonë i vetëdijshëm se Allahu ishte pranë tij dhe se Ai dëgjonte dhe shihte vëllezërit e tij kur ata po i përgatitnin kurthin atij. Allahu e siguroi Profetin Jusuf (as):



Pasi që ata shkuan me të dhe vendosën ta vënë në fund të pusit, Ne i shpallëm: "Ti do t'i njoftosh ata për këtë vepër të tyre, e duke mos ditur ata (do të vijë koha t'ju thuash për këtë vepër e ata nuk do të dinë se ti je Jusufi)". (Sure Jusuf: 15)

Vargu i mësipërm e vë theksin mbi dy çështje tjera. E para është mënyra se si vëllezërit e tij bashkëpunuan kur e hodhën Profetin Jusuf (as) në pus. Mbase menduan se do të mund të merrnin përgjegjësi të përbashkët për këtë vepër por të menduarit e tyre ishte shumë i gabuar. Në të vërtetë, sjellja e tyre vetëm dëshmon se atyre u mungonte vetëdija pasi që asnjëri prej tyre nuk u

ngrit kundër rrjedhës së veprimit që kishin ndërmarrë.

Prej kësaj mund të vijmë në përfundim se ngatërrestarët jo vetëm se janë në gjendje të ndërmarrin veprim të organizuar kundër besimtarëve, por se ata gjithashtu përbëjnë lëndë të përsosur për protesta masive shoqërore.

Gjithashtu, në ajetin e mësipërm mund të shihet se Allahu e ndihmoi Profetin Jusuf (as) me anë të frymëzimit të Tij, duke e njoftuar për të ardhmen madje në atë moment që dukej të ishte momenti më i errët i jetës së tij. Kjo në vetvete është një mrekulli. Nëse e shikojmë këtë nga këndvështrimi i Profetit Jusuf (as), kjo ishte një mirësi e madhe. Marrja e frymëzimit prej Allahut atëherë kur po e hidhnin në pus dhe sigurimi i tij nga ana e Allahut ishte ndihma dhe përkrahja më e madhe që ai mund të kishte. Me fjalë të tjera, që nga momenti që ishte hedhur në pus, Profeti Jusuf (as) dinte përmes frymëzimit të Allahut se të gjitha kurthet e tyre do të asgjësoheshin. Ai ishte i sigurt dhe i qetë për shkak të besimit të tij në premtimin e Allahut.

Mirëpo, nuk duhet harruar se një besimtar i sinqertë gjithnjë mbështetet në Allahun, pa marrë parasysh se me çfarë vështirësi apo fatkeqësi ndeshet, madje edhe nëse nuk është frymëzuar dhe pranon çfarëdo që ndodhë. Kjo për shkak se Allahu ka njoftuar besimtarët se Ai do të jetë gjithmonë pranë tyre:

***Allahu kurrsesi nuk iu mundëson jobsimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.
(Sure Nisa: 141)***

Askush që sinqerisht beson në këtë premtim të Allahut kurrë s'mund të shqetësohet prej kurtheve të kurdisura nga ngatërrestarët dhe jobesimtarët.

TNatyra superiore e Profetit Jusuf (as) buron prej vlerave të tij morale dhe nënshtrimit ndaj vullnetit të Allahut. Edhe pse ai ende ishte një fëmijë i vogël, ai ishte shumë i pjekur. Duhet ta marrim me mend se çfarë ndjenje duhet të ketë qenë hedhja në pus për një fëmijë aq të vogël. Vargu flet për hedhjen e tij në thellësitë e pusit, që domethënë se ai ishte në një vend të errët. Ishte në një



vend ku kërcënimi për vdekje ishte i madh dhe nuk ishte e sigurt se do të mund të gjendej ndonjëherë. As që mund ta merrte me mend se çfarë njerëz, nëse kushdo, do ta gjenin atë dhe nëse ata do të ishin të mirë apo të këqij. Dikujt që i mungon nënshtrimi ndaj vullnetit të Allahut mund të ketë vështirësi të mëdha dhe të dërmohet prej dyshimeve në rrethana të tilla. Mirëpo, përkundër gjithë kësaj, Profeti Jusuf (as) ishte i durueshëm dhe i nënshtruar ndaj vullnetit të Allahut. Ky është një tregues i qartë i vetëdijes së tij superiore. Është po ashtu e qartë nga fakti se ai ishte sprovuar në këtë mënyrë në një moshë aq të re se kjo nënkuptonte se ai kur të rritej do të ishte prej të zgjedhurve, pasi që vetëm ata që janë sinqerisht të devotshëm ndaj Allahut dhe që i nënshtrohen vullnetit të Tij mund të kalojnë sprova të tilla.

Në vështrim të parë, rrethanat në të cilat u gjend Profeti Jusuf (as) dukeshin vërtetë të frikshme. Ai po kalonte nëpër një sprovë të vështirë. Mirëpo, në dritën e vargut: **“E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi...”** (Sure Inshirah: 5) Allahu e ndihmoi atë dhe i bëri një premtim që e qetësoi atë dhe i dha qetësi dhe siguri.

JETA E RE E PROFETIT JUSUF (as)

DALJA E PROFETIT JUSUF (as) NGA PUSI

Vargu vijues na njofton për mënyrën se si Profeti Jusuf (as) doli nga pusi:

Dhe atypari kaloi një grup udhëtarësh, e pastaj dërguan ujëmbartësin (për ujë), e ai e lëshoi kovën e vet (në pus) dhe tha: "Myzhde, e gjeta një djalosh!" Ata e fshehën atë si mall tregtie. Po Allahu e dinte shumë mirë se ç'vepronin ata. (Sure Jusuf: 19)

Momenti kur Profeti Jusuf (as) u hodh në pus dhe momenti kur ai u nxjerr prej pusit ishin të dyja ndodhi të përcaktuara në fatin e tij. Asgjë nuk ndodhë jashtë fatit të paracaktuar të njeriut. Për atë arsye karvani që do të kalonte pranë pasi që Jusufi (as) të ishte hedhur në pus, destinacioni i tij dhe soji i njerëzve në karvan

PROFETI JUSUF (AS)



The bottom two pictures show the traveling caravans en route to Egypt. The map shows the route taken by the caravans of the time, and the drawing in the centre depicts the caravan's water-gatherers pulling Prophet Yusuf (as) out of the well.



të gjitha ishin të përcaktuara me paracaktimin e Allahut madje para se të lindte profeti (as). Besimtarët që kuptojnë këtë të vërtetë të rëndësishme gjithnjë i nënshtrohen vullnetit të Allahut për këtë arsye.

Siç mund të shihet nga ky varg, grupi që e gjeti Profetin Jusuf (as) në pus dhe e shpëtoi atë menduan se do të jenë në gjendje ta shesin atë dhe e konsideruan si mall. Kjo për arsye se sistemi i robërisë ende ishte dominues në Egjipt dhe në rajonin përreth. Njerëzit merreshin në mënyrë aktive me tregti, në veçanti me



Top left; an image of Prophet Yusuf (as) being sold into slavery for a cheap price. Top right; A representation of the slavery current in Egypt at the time. Right; A document of the time giving information about slavery in Egypt.



They sold him for a pittance, a few small coins, considering him to be of little worth. (Surah Yusuf: 20)



Bottom; The surviving remains of an Egyptian slave market. Side; The slave market from a film about the life of Prophet Yusuf (as).



blerjen dhe shitjen e fëmijëve. Ky ishte shkaku pse njerëzit që e gjetën atë kishin arsye të ngazëlleshme për mundësinë që të nxjerrin përfitim prej tij. Mirëpo, vazhdimi i vargut zbulon se ata nënvlerësuan vlerën e tij dhe e shitën atë me një çmim të ulët:

Dhe e shitën atë (Jusufin) për një çmim të vogël, për disa dërrhemë (masë argjendi) të numëruar, sepse në mesin e tyre pati të atillë që nuk lakmuan (për çmim më të lartë). (Sure Jusuf: 20)

Në të vërtetë ka një urtësi të madhe në këtë punë. Po të kishin përcaktuar një çmim të lartë për të, po të kishin kuptuar se ai ishte një personalitet i zgjedhur, një profet, ata do të dëshironin ta dëmtonin atë. Ngjashëm, jobesimtarët e tjerë të cilët do të dëgjonin për këtë gjithashtu do të dëshironin t'i shkaktonin ndonjë të keqe atij. Fakti se ata e nënvlerësuan atë dhe e shitën si rob duke shpresuar një përfitim material shkoi në favor të tij.

Urtësia pas kësaj ngjarjeje në jetën e Profetit Jusuf (as) qëndron në mënyrën se si shfaq dobinë dhe mbrojtjen e madhe për besimtarët që është e fshehur në prirjen e përgjithshme të jobesimtarëve t'i nënvlerësojnë ata, duke i konsideruar si të pavlerë dhe të parëndësishëm.

Ka edhe një çështje të rëndësishme këtu. Siç e dimë, Profeti Jusuf (as) njihej për bukurinë e tij të jashtëzakonshme. Mirëpo siç kemi parë, kjo bukuri ende nuk ishte bërë e dukshme në kohën kur ai ra në duart e tregtarëve të skllëvërve. Ata nuk arritën të kuptojnë se çfarë personaliteti i vlefshëm ishte ai, duke e cilësuar atë thjeshtë si një "fëmijë." Kjo domethënë se Allahu në




Examples of the splendid buildings in Egypt from the time of Prophet Yusuf (as).

urtësinë e Tij kishte mbajtur të fshehtë këtë bukuri në atë kohë, që ishte edhe një shprehje e ndihmës dhe mbrojtjes së Tij.

Sipas Kuranit, Profeti Jusuf (as) u gjet nga tregtarët e skllëvërve dhe iu shit një Egjiptiani. Kjo rrëfëhet si në vazhdim:

E ai që e bleu nga Misiri (Egjipti) i tha gruas së vet: "Bëni pritje të kënaqshme, se është shpresë t'ia shohim hajrin ose ta adoptojmë për fëmijë!" Ja, kështu (sikurse e shpëtuam nga pusi), Ne i bëmë vend Jusufit në tokë (në Egjipt), e që t'ia mësojmë atij shpjegimin për disa ëndrra. Allahu është mbizotërues i punës së Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve). (Sure Jusuf: 21)

Me anë të këtij Egjiptiani që e bleu atë, Allahu siguroi që Profeti Jusuf (as) të ishte i mbrojtur, i përkujdesur mirë dhe iu



A mural depicting scenes from the daily life of the time.

mundësua të rritet i qetë në Egjipt. Blerësi i tij atë ia besoj gruas së tij në një mënyrë shumë të mirë dhe të dhimbshme, duke e këshilluar atë që të përkujdesej mirë për të. Në të vërtetë, ata menduan se Jusufi (as) mund të ishte shumë i dobishëm për ta dhe madje menduan ta birësojnë atë. Kjo është edhe një dëshmi tjetër e ndihmës, përkrahjes dhe dashurisë dhe dhembshurisë (mëshirës) së Allahut për profetin (as). Allahu e shpëtoi atë prej rreziqeve të pusit, e vendosi atë në një vend të përshtatshëm dhe Egjiptin e bëri shtëpi të tij. Të gjitha këto ishin mirësi prej Allahut.

Veç kësaj, Allahu i dha Profetit Jusuf (as) dijeni, duke e mësuar atë të interpretoj fjalët e njerëzve. Nuk ka dyshim se kjo është një aftësi e madhe dhe në të njëjtën kohë një mirësi, të cilën

Allahu ua dhuron atyre që do Ai prej robërve të Tij. Vargu në lidhje me këtë thotë:

Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush. (Sure Bekare: 269)

AI PËRGOJOHET KUR ARRIN PJEKURINË

Kështu pra ndodhi që Profeti Jusuf (as) filloi të jetoj me Egjiptianin, Azizin. Sikur që e mësoi t'i interpretoj fjalët e njerëzve, Allahu gjithashtu i dhuroi aftësi të gjykuarit dhe dijani kur arriti pjekurinë. Aftësia e të gjykuarit të cilës i referohemi në vargun përkatës është aftësia për të sjellë vendim të drejtë të pajtueshëm me kufizimet e Allahut. Dijenia, në anën tjetër, mund të jetë aftësia e të mësuarit ose mbase aftësia për të kuptuar aspektet e brendshme të gjërave (padyshim se Allahu e di më së miri). Të gjithë këta janë tregues se Allahu e kishte veçuar atë për sjelljen e tij të drejtë dhe e kishte bekuar atë. Kjo e vërtetë është përshkruar në Kuran si në vazhdim:

E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët. (Sure Jusuf: 22)

Mirëpo, kur Profeti Jusuf (as) arriti pjekurinë, zonja e shtëpisë ku ai jetonte, gruaja e Azizit tentoi ta joshte atë. Një mjedis i përshtatshëm ishte përgatitur për këtë qëllim. Të gjitha dyert



A depiction of the wife of the Egyptian official who attempted to "solicit" Prophet Yusuf (as), in the words of the Qur'an.

ishin mbyllur mirë dhe profetit (as) iu bë një propozim i pahijshëm. Përgjigja e tij në këto rrethana është shembull i sjelljes së moralshme që të gjithë besimtarët duhet të përpiqen të arrijnë.

Së pari dhe para së gjithash, edhe pse gruaja e dëshironte atë, ai kërkoi mbrojtje tek Allahu përpara se të bënte një mëkat aq të shëmtuar, i cili do t'ishte shkelje e urdhrave të Allahut. Ai pastaj u soll në mënyrë besnike dhe të qytetëruar, duke ia përkujtuar Azizin gruas së tij dhe duke i thënë se ai ishte përkujdesur për të dhe ishte sjellë mirë me të. Në këtë mënyrë, ai ia bëri asaj plotësisht të qartë se ai nuk mund të bënte një vepër të tillë të pabesisë ndaj Azizit. Menjëherë pas kësaj ai pohoi se keqbërësit nuk mund të shpresonin për shpëtim dhe se kjo do të ishte një sjellje mizore. Kurani rrëfen këtë ngjarje si në vazhdim:

E ajo, në shtëpinë e së cilës ishte Jusufi, i bëri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: "Eja!" Ai

(Jusufi) tha: "Allahu më ruajt, ai zotëriu im (e burri yt), më nderoi me vendosje të mirë (si mund t'i bëj hile në familje)?" S'ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses. Ajo e mësyjti atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj, sikur të mos i prezantohej argumenti nga Zoti i tij. Ashtu (e bëmë të vendosur) që të largojmë nga ai të keqen dhe të ndytën. Vërtet, ai ishte nga robërit tanë të zgjedhur. (Sure Jusuf: 23-24)

Siç bëhet e qartë në vargjet e mësipërme, Profeti Jusuf (as) e dinte se tradhtia bashkëshortore ishte mëkat në sytë e Allahut. Ai prandaj iu shmang bërjes së mëkatit dhe u përpoq të ik prej kësaj gruaje. Mënyra se si Allahu tregon se ai do ta kishte dashur atë, përmban një fshehtësi shumë të rëndësishme në lidhje me këtë sprovë. Është e mundshme që epshet e një besimtari të



A depiction of the virtuous behaviour of Prophet Yusuf (as) in the face of the woman's improper suggestion. She is tearing the back of Prophet Yusuf's shirt (as).

drejtohen drejt diçkaje që është mëkatore sipas fesë së tij. Ajo që është e rëndësishme për besimtarin është që të refuzojë t'i bindet atij epshi dhe të demonstrojë vendosmërinë për të mos i tejkalar kufijtë që ka përcaktuar Allahu. Nuk do të kishte asnjë sprovë nëse ai s'do të kishte dëshira fizike. Ngjarjet pasuese rrëfohen në vargjet vijuese:

Dhe, që të dy ata vrapuan kah dera, e ajo ia grisi këmishën e tij nga mbrapa dhe pranë dera ata të dy takuan burrin e saj, e ajo tha: "Çfarë mund të jetë ndëshkimi i atij që tenton të keqen në familjen tënde, përpos të burgoset, ose dënim të dhembshëm!?" (Sure Jusuf: 25)

Pas kësaj ngjarjeje, gruaja filloi të shpifë për Profetin Jusuf (as), përkundër sjelljes së tij të moralshme dhe shmangies së tradhtisë bashkëshortore. Edhe pse ai ishte plotësisht i pafajshëm, ajo i tha burrit të saj, vezirit, se Jusufi (as) iu kishte afruar asaj me qëllime të këqija, duke kërkuar që ai ose të futej në burg ose të torturohej. Ky është një tregues i qartë se gruaja nuk kishte frikë prej Allahut dhe kishte një dell mizor. Propozimi i pahijshëm që ajo i bëri Jusufit (as) ishte sidoqoftë treguesi më i rëndësishëm i karakterit të saj të degjeneruar. Mënyra se si ajo sajoi këto akuza të rrejshme dhe kërkonte që ai të dënohej, përkundër pafajësisë së tij, ishte thjeshtë një shprehje e atij degjenerimi të rrënjosur. Profeti Jusuf (as) u përgjigj në këtë mënyrë:

Ai (Jusufi) tha: "Ajo m'u vërsul mua!" Një dëshmitarë nga familja e saj gjykoi: "Nëse

këmisha e tij është grisur përpara, ajo ka thënë të drejtën, kurse ai gënjen. E nëse këmisha e tij është grisur prapa, atëherë gënjen ajo, kurse ai është i drejtë.” (Sure Jusuf: 26-27)

Në këtë situatë, fakti se gruaja kishte grisur këmishën e Profetit Jusuf (as) nga ana e prapme është dëshmi se ai kishte ikur në drejtim të derës ndërsa gruaja e kishte ndjekur pas. Sipas vargjeve, pafajësia e profetit ishte dëshmuar:

E kur e pa ai (burri i saj) këmishën e tij të grisur prapa, tha: "Kjo është dredhi juaja, vërtet dredhia juaj është e madhe! Jusuf, largohu nga kjo (mos ia përmend askujt)! E ti (gruas) kërko falje për mëkatin tënd, se vërtet ti qenke fajtorë!" (Sure Jusuf: 28-29)

Azizi e kuptoi se Profeti Jusuf (as) ishte i pafajshëm dhe tha se kjo ishte një dredhi e gruas së tij. Fjalët e tij, që rrëfohen në vargjet e mësipërme, janë dëshmi se Azizi ishte më i ndërgjegjshëm se gruaja e tij. Mirëpo ngjarja nuk mbaroi me kaq. Zhvillimet pasuese rrëfohen në Kuran:

Një grup nga gratë e qytetit thanë: "Gruaja e zotëriut (e ministrit) i vërsulet marrëzisht shërbëtorit të vet, atë e ka kapluar në shpirt dashuria, e ne jemi të bindura se ajo është në humbje të hapët. (Sure Jusuf: 30)

Siç mund të shohim, ngjarja u përhap në mesin e grave të qytetit. Mënyra se si u është tërhequr vëmendja grave në këtë ajet mund të ketë për qëllim të tregoj se si virtytet morale të njerëzve të paditur shkojnë dora dorës ose me përgojim ose me karakter ngatërrestar. (Padyshim se Allahu e di më së miri.)

Gratë e qytetit pastaj filluan të flasin kundër gruas së vezirit, duke i dënuar veprimet e saj. Ato kuptuan se Profeti Jusuf (as) nuk ishte fajtor por gruaja e Azizit, e cila u shqetësua nga kritika që i bëhej asaj. Në të vërtetë, njerëzit që e shpërfillin kënaqësinë e Allahut dhe që në vend të kësaj kanë për qëllim të kënaqin njerëzit tjerë, janë prej atyre që më së shumti i frikësohen të qenit të nënvleftësuar në sytë e njerëzve dhe të dëmtimit të imazhit të tyre. Njëra prej gjërave që këta njerëz që nuk i frikësohen Allahut më së tepërmi i frikësohen në fakt, është që gjërat që ata bëjnë në fshehtësi të zbulohen prej të tjerëve. Kjo ishte pozita në të cilën u gjet gruaja e Azizit.

Kur gruaja e Azizit e kuptoi se ajo ishte bërë objekt i thashethemeve të grave ajo përgatiti një kurth për to. Qëllimi i saj ishte të dëshmojë se ajo nuk mund të fajësohej plotësisht për nënshtrimin e saj ndaj epsheve të pamoralshme në lidhje me Profetin Jusuf (as), sepse ai ishte një mashkull jashtëzakonisht i bukur. Me të vërtetë, gratë tjera u mahnitën nga bukuria e Profetit Jusuf (as):

E kur ajo dëgjoji për ato pëshpëritjet e tyre, dërgoi t'i thërrasë ato, u përgatiti vendmbështetje dhe secilës prej tyre i dha nga një thikë e tha: "Dil para atyre!" Kur e panë atë, ato u tronditën dhe i prenë duart e tyre e thanë: "Allahut

i qofshim falë! Ky nuk është njeri, ky nuk është tjetër vetëm se ndonjë engjëll i lartë!"
(Sure Jusuf: 31)

Siç tregon ajeti i mësipërm, bukuria e Profetit Jusuf (as) u përkujtoi grave Allahun dhe nuk kishin zgjidhje tjetër vetëm se t'i drejtohen Atij në mënyrë spontane përballë kësaj bukurie. Ato e konsideruan bukurinë e tij si diçka mbinjerëzore dhe madje pohuan se ai ishte një engjëll. Nëse rikujtojmë, Allahu kishte fshehur bukurinë mahnitëse të Profetit Jusuf (as) kur ai ishte fëmijë, duke e mbrojtur atë në këtë mënyrë. Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me arritjen e pjekurisë nga ana e Profetit Jusuf (as), ajo bukuri filloi të tërheq shumë vëmendjen e njerëzve. Këtu padyshim se ka urtësi të madhe të fshehur përbrenda secilës prej këtyre hollësirave. Vazhdimi i këtij tregimi zbulon se çfarë ndodhi pas kësaj:

Ajo tha: "Ja, ky është ai për të cilin më qortuat mua, e unë u përpoqa ta josh atë, por ai refuzoi. Po qe se nuk bën çka e urdhëroj, ai gjithqysh do të burgoset dhe do të nënçmohet".
(Sure Jusuf: 32)

Siç mund të shohim, gruaja pranoi haptazi fajësinë e saj dhe pranoi se Profeti Jusuf (as) kishte dashur ta mbrojtë dëlirësinë e tij. E prapeseprap ajo përsëriti po atë propozim të shëmtuar përpara një numri të madh të njerëzve, duke e urdhëruar Profetin Jusuf (as) të shkonte bashkë me të dhe iu kërcënua atij me burg dhe poshtërim publik nëse ai do të refuzonte t'i bindej. Nga kjo mund të shihet se sa mizore dhe e privuar nga integriteti moral ishte kjo

grua. Kjo natyrisht se është një situatë më se e habitshme. Ndoshta ishte siguria e gruas në pozitën e saj në Egjipt, në pasurinë e saj dhe në faktin se Profeti Jusuf (as) ishte rob i saj që e shtyri atë të bëj këtë mëkat. Ky ishte një propozim më se i çoroditur dhe gruaja e Azizit nuk ndjente kurrfarë brejtjeje të ndërgjegjes sa i përket përsëritjes së tij përpara të gjithë të pranishmëve. Kjo është dëshmi si për mungesën e vlerave fetare të saj ashtu edhe për lirinë që gratë tjera kishin në çështjet fetare. Në të njëjtën mënyrë në të cilën asnjë grua e devotshme s'do të mund të bënte kurrë një mëkat të tillë, po ashtu asnjë grua e devotshme s'do të mund të qëndronte kurrë anash dhe të shikonte gjersa ndodhte një gjë e tillë. Veç kësaj, gratë e përshkruara në këtë tregim qëndruan të heshtura përballë kërcënimeve të shprehura nga gruaja e vezirit dhe u treguan të verbëta ndaj veprimeve të shëmtuara të saj.

Kurani gjithashtu rrëfen se si Azizi nuk e kundërshtoi futjen në burg të Profetit Jusuf (as), edhe pse ai kishte parë gjithçka me sytë e tij. Në të njëjtën mënyrë gruaja e tij u tregua e verbër ndaj burgosjes së Jusufit (as) vite me radhë. Siç mund të shihet nga ky shembull, mosbesimtarët gjithmonë përkrahin njerëzit e një gjendjeje të ngjashme shpirtërore dhe janë në gjendje të rrinë duarkryq dhe të shikojnë dhe të qëndrojnë të heshtur, ndërsa thuren dhe jetësohen plane të shëmtuara. Shohim se si gratë e qytetit në këtë tregim parapëlqyen të heshtin, duke u bërë kështu pjesëmarrëse në komplot. Ato madje nuk e përkrahën Profetin Jusuf (as) kur gruaja e Azizit pranoi, por qëndruan duarkryq dhe shikuan se si një njeri i moralshëm po futej në burg.

Edhe një faktor tjetër i rëndësishëm këtu është sinqeriteti i Profetit Jusuf (as). Ai menjëherë kërkoi mbrojtje tek Allahu dhe ia

hapi zemrën Atij sinqerisht dhe e luti për ndihmë. Sinqeriteti i madh dhe pastërtia e zemrës ilustrohen me sjelljen e tij:

Ai (Jusufi) tha: "O Zoti im, burgu është më i dëshiruar për mua, se sa atë që më ofrojnë ato mua dhe nëse Ti nuk largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të anoj te ato e të bëhem injorant. E Zoti i tij ia pranoi lutjen atij dhe e largoi nga ai dredhinë e tyre. Vërtet, Ai është që dëgjon (lutjet) dhe di (gjendjen). (Sure Jusuf: 33-34)

Aspekti më mahnitës i kësaj pjese të tregimit është prirja e grave për kurdisjen e kurtheve. Njëri prej mësimëve që duhet të nxjerrim nga kjo ngjarje është se besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj grave që nuk kanë dijeni për çështje të tilla. Pasi që ato janë të pavëmendshme ndaj asaj se çka është e ligjshme e çka është e paligjshme dhe janë të pavetëdijshe për kufijtë që Allahu ka përcaktuar për arsye të ndryshme, ato kanë prirje të bëjnë mëkate për të kënaqur krenarinë e tyre; ndonjëherë për shkak të nënshtrimit ndaj epsheve të tyre fizike dhe ndonjëherë me qëllim që t'i vënë besimtarët në pozitë të vështirë. Gra të tilla ndonjëherë mund të ngritin kurthe për meshkujt besimtarë, por duhet ta bëjmë të qartë, megjithatë, se këtu nuk po bëjmë fjalë për të gjitha gratë, por vetëm për ato që janë të paditura dhe që nuk i frikësohen Allahut.



Prophet Yusuf (as) spent long years in a dungeon despite the fact that his innocence had been clearly proved. The above picture shows an Egyptian prison of the time.

JUSUFI (AS) I PAFAJSHËM FUTET NË BURG

Siç kemi parë tashmë, gruaja e Azizit pranoi përpara grave të qytetit se ajo kishte bërë plane për Profetin Jusuf (as) dhe se ai e kishte refuzuar atë. Azizi kishte mendim të njëjtë, duke i përkujtuar gruas së tij se ajo ishte një mëkatare që duhej t'i lutej Allahut për falje. Me fjalë të tjera, kushdo që ishte dëshmitar dhe që dëgjoi për këto ngjarje e kuptoi se Profeti Jusuf (as) ishte i pafajshëm dhe viktimë e intrigave që kishte sajuar kjo grua. Megjithatë, përkundër kësaj, ata sollën vendim fare të pandërgjegjshëm dhe e futën Profetin Jusuf (as) në burg:

Mandej, pasi që vërtetuan argumentet (e pastërtisë së Jusufit), atyre (ministrit dhe rrethit të tij) iu paraqit ideja që ta burgosin atë për një kohë. (Sure Jusuf: 35)

Ajo që ka rëndësi më së shumti këtu është se ata ishin në gjendje ta futnin një person plotësisht të pafajshëm në burg. Ajo që del në shesh prej kësaj është se sistemi që mbizotëronte në atë shoqëri në atë kohë nuk ishte një sistem i bazuar në drejtësi, por një sistem në të cilin fuqia konsiderohej si e drejtë. Veç kësaj, fakti se ata ishin në gjendje ta burgosin një njeri që ishte plotësisht i pafajshëm dhe për të cilin faktet tregonin se ishte plotësisht i pafajshëm, dëshmon se sistemi i tyre ligjor ishte një sistem që ata ishin në gjendje ta ndryshojnë sipas dëshirës në pajtim me interesat e tyre.

Kjo është pjesë e ligjit të pandryshueshëm të Allahut; jobesimtarët, në veçanti ata që i refuzojnë të dërguarit e Tij, gjithmonë përpiqen të burgosin dhe të vendosin pengesa në udhën e besimtarëve. E njëjta gjë ndodhi në kohën e Profetit tonë, Muhammedit (saas). Allahu përshkruan këtë të vërtetë me këto fjalë:

Përkujto (o i dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje; të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë. Ata bënin plane, e Allahu i asgjëson, se Allahu është më i miri që asgjëson (dredhitë). (Sure Enfal: 30)

Siç mund të shihet, kjo situatë me të cilën Myslimanët dhe

të dërguarit e Allahut u përballën në secilën kohë gjithashtu iu imponua Profetit Jusuf (as). Po të mos kishte qenë Profeti Jusuf (as) Mysliman dhe po t'ï ishte përkulur sistemit të tyre paragjykues dhe moralisht të degjeneruar, atëherë ata nuk do të ishin aq armiqësor ndaj tij dhe madje do të shtireshin se nuk shohin nëse ai do të kishte bërë ndonjë krim. Megjithatë, arsyeja kryesore e armiqësisë së tyre ndaj tij ishte fakti se ai ishte një Mysliman i pastër që çmonte mbi të gjitha kënaqësinë e Allahut dhe zbatimin në mënyrë të prerë të urdhrave dhe ndalimeve të Tij. Siç na është thënë në disa prej vargjeve Kuranore, njerëzit që ishin të larguar prej fesë gjithmonë kanë ushqyer një armiqësi të ngjashme ndaj besimtarëve.

Sikur që futja në burg e Profetit të pafajshëm Jusuf (as) dëshmon se çfarë sistemi i padrejtë ligjor mbizotëronte në Egjipt, ajo gjithashtu shfaq degjenerimin moral që ishte i pranishëm në shoqërinë si tërësi të asaj kohe.

“E GJITHË THURJA E KOMPLOTEVE I TAKON ALLAHUT”

Sipërfaqësisht, ngjarjet që kemi përshkruar deri më tani do të mund të konsideroheshin si “fatkeqësi” të përjetuara nga Profeti Jusuf (as). Megjithatë, një vështrim në thelb i kësaj çështjeje tregon se Allahu bëri që gjithë kjo të ndodhte dhe paracaktoi ngjarjet. Siç kemi pohuar më herët, këto ngjarje ishin të gjitha pjesë e fatit të paracaktuar të Profetit Jusuf (as) dhe të gjitha ishin tejet të mbara për të (as). Me të vërtetë, dikush që i nënshtrohet një sprove të tillë që burgoset pa faj dhe akoma mbetet i durueshëm dhe i nënshtruar ndaj vullnetit të Allahut nën rrethana të tilla, është njeri që posedon një vetëdije të vërtetë për Zotin. Është e qartë se

një person i tillë do të fitojë dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Nga ky këndvështrim, burgosja e Profetit Jusuf (as) ishte shumë larg qenies një gjë e keqe apo një tragjedi, përkundrazi, ishte një ndodhi më se pozitive.

Veç kësaj, tregimi tërheq vëmendjen ndaj mënyrës se si jobesimtarët apo ngatërrestarët bashkohen për të ngritur kurthe kundër besimtarëve. Megjithatë, siç e kemi bërë tashmë të qartë, këta njerëz në të vërtetë kurrë nuk mund t'u shkaktojnë dëm besimtarëve. Ekziston një kurth i ngritur përbrenda planit gjithëpërfshirës të Allahut që rrethon kurthet që ata ngritin për të tjerët. Kur ata ngritin kurthet e tyre, Allahu dëgjon dhe din çdo gjë që ata thonë, vendimet e tyre dhe mendimet e tyre më të thella, deri në hollësinë më të vogël. Në të vërtetë, fakti se ata do të ngritin kurthe për besimtarët tashmë ishte i ruajtur në fatet e tyre shumë kohë përpara se ata të lindnin. Allahu gjithashtu kishte përcaktuar në fatet e tyre ato ngjarje që do të asgjësonin kurthet e tyre. Për atë arsye, çdo kurth i ngritur për besimtarët vjen në jetë si dështim. Allahu zbulon këtë fshehtësi në Kuran:

Edhe ata (jobesimtarët) para tyre (idhujtarëve) bënë intrigë, po e gjithë intriga është e nënshtruar dëshirës së Allahut, Ai e di se çka vepron secili njeri, e mohuesit do ta kuptojnë se kujt do t'i takojë ardhmëri e lumtur. (Sure Rra'd: 42)

Ata përgatitën kurthin e tyre, por kurthi i tyre gjendet në duart e Allahut, qoftë ai kurthi i tyre që të bëj edhe kodrat të zhduken. E kurrs-

esi mos mendo se Allahu e shkel premtimin e vet, që u dha të Dërguarve të Tij. Allahu është triumfues që ndërmerr masa ndëshkuese. (Sure Ibrahim: 46-47)

Andaj për këtë arsye besimtarët i nënshtrohen vullnetit të Allahut kur ndeshen me situata të tilla dhe kuptojnë se kurthet e ngritura për ta tashmë janë neutralizuar. Pa marrë parasysh se sa është i fuqishëm kurthi i ngritur për ta ata gjithmonë reagojnë qetësisht dhe në mënyrë të përmbajtur. Kjo buron nga besimi që ata kanë në Allahun dhe besimi i tyre në Librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij. Prandaj, kjo është një fshehtësi e veçantë për besimtarët, pasi që është e pamundur për njerëzit që nuk besojnë dhe që jetojnë jetët e tyre të larguar shumë prej fesë, të kenë një qetësi të tillë shpirtërore.

DITËT QË JUSUFI (AS) KALOI NË BURG

PROFETI JUSUF (AS) DHE SHOKËT E TIJ TË QELISË

Kurani na informon se dy të rinj tjerë u futën në burg së bashku me Profetin Jusuf (as) dhe se ata kërkuan prej tij që t'ju interpretoj ëndrrat e tyre:

Së bashku me të hynë në burg dy të rinj. Njëri prej atyre dyve tha: "Unë ëndërrova veten se po shtrydhi (rrush për) verë". E tjetri tha "Unë ëndërrova se po bart mbi kokë një bukë nga e cila hanin shpezët". Na trego komentimin e saj, se ne të konsiderojmë nga komentuesit e mirë (të ëndrrave). (Sure Jusuf: 36)

Do t'ju përkujtojmë se Allahu kishte mësuar Profetin Jusuf (as) të interpretonte fjalët e njerëzve. Kjo ishte arsyeja pse shokët e tij të qelisë kërkuan prej tij t'ju interpretonte ëndrrat e tyre. Një gjë meriton të përmendet këtu: Si e dinin ata se Profeti



The verses speak of two young men entering the dungeon together with Prophet Yusuf (as). These two can be seen in the picture above.

Jusuf (as) posedonte dituri dhe urtësi të tillë?

Thënia në pjesën në vazhdim të këtij ajeti jap përgjigjen në këtë pyetje; të tjerët në burg thanë se e konsideronin atë si **“prej të drejtëve (komentuesve të mirë).”** Kjo tregon se gjatë qëndrimit të tij në burg Profeti Jusuf (as) u soll si një besimtar i vërtetë, gjë që u bëri përshtypje njerëzve përreth tij. Duket se sjellja, karakteri dhe pamja e jashtme e Profetit Jusuf (as) ishin të gjitha të atilla që frymëzonin besim tek të tjerët. Në të vërtetë, madje edhe shprehja e fytyrës e dikujt mund të ndikoj që njerëzit përreth të ndjejnë se ai është një besimtar i vërtetë. Kur Allahu iu referohet besimtarëve në Kuran, Ai thotë: **“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes...”** (Sure Fet’h: 29)

Shenjat e gjurmës së sexhdes për të cilat bëhet fjalë këtu me siguri se nuk janë të kufizuara në shenjat fizike që rezultojnë nga lutjet e gjata, por gjithashtu përmbajnë “dritën e besimit” që

ndriçon fytyrën e një personi (Padyshim se Allahu e di më së miri).

Ndershmëria e shfaqur prej Profetit Jusuf (as) në burg na tregon një cilësi të rëndësishme të besimtarëve; besimtari shfaq kudo që mund të jetë ai integritet të njëjtë madhështor. Kjo për arsye se besimtarët jetojnë për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe Allahu është gjithandej në diturinë e Tij. Allahu është gjithmonë me besimtarin, qoftë në burg, në shtëpi, kur ec në rrugë, kur shkruan në tavolinë, kur han apo shikon televizionin. Ai pushton besimtarin dhe din çdo gjë që ai thotë ose që i shkon në mendje. Ja



These ancient Egyptian pictures describe the dreams of the two young men who were imprisoned with Prophet Yusuf (as). The top picture shows the young man preparing wine. Underneath can be seen the bird eating the bread the young man was carrying on his head.

përse parapëlqimi i besimtarit për sjellje të mirë dhe parime morale nuk ndryshon sipas gjendjes së tij. Besimtarët vazhdimisht përpiqen të shfaqin një standard të lartë të qëndrueshëm të moralit dhe vetëdijes.

Kjo ishte arsyeja pse shokët e qelisë të Profetit Jusuf (as) i besonin atij, kuptuan se ishte njeri i mirë dhe kërkuan këshillën e tij. Profeti Jusuf (as) filloi të flas pasi që ata ia bënë këtë kërkesë. Megjithatë, siç do të shihet prej vargjeve më poshtë, ai ndoqi një rrugë shumë të zgjuar kur e bëri këtë. Ai drejtoi rrjedhën e bisedës në drejtimin që ai konsideronte si më të përshtatshmin dhe u mor më çështjet që ai i konsideronte më të rëndësishme dhe më të ngutshme para se të kalonte në çështjet që atyre ju interesonin më së shumti:

Tha: "Nuk ju vjen juve ndonjë ushqim me të cilin ushqeheni, e që unë të mos dijë, t'ju përshkruaj atë para se t'ju vijë. Kjo është nga ajo çka më mësoi Zoti im. Unë kam braktisur fenë e një populli që nuk e beson Allahun as botën tjetër, e ata ishin jobesimtarë". Unë e ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is-hakut, Jakubit. Neve nuk na takoi t'i përshkruajmë kurrë një send shok Allahut. Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe nga Allahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën. O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të

***ndryshëm ose Allahu, i vetmi ngadhënjimtar?"
Ata që ju adhuron përveç Allahut, nuk janë
tjetër vetëm se emra që pagëzuar ju dhe
prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt
për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i
takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos
adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e
drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.
(Sure Jusuf: 37-40)***

Siç mund të shihet, Profeti Jusuf (as) u foli atyre për njësinë e Allahut dhe të këqijat e politeizmit. Ai e shpjegoi karakterin e shtrembëruar të sistemit të paditurisë në të cilin ata jetuan dhe u rekomandoi që të jenë vetëm në shërbim të Allahut.

Gjersa ai fliste, ai gjithashtu u dha shembuj të profetëve të kaluar, duke përkujtuar se si të gjithë ata ishin pjesë e të njëjtës fe Hyjnore.

Ai gjithashtu bëri pyetje për t'i nxitur njerëzit me të cilët po fliste të mendojnë. Për shembull, ai pyeti: "...a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari?" duke përkujtuar në të njëjtën kohë emrin e Allahut si i Vetmi Ngadhënjimtar. Pra ai u përpoq që t'i bënte ata të mendojnë dhe të kenë frikë dhe të nderojnë madhësinë e Allahut.

Ai pastaj përkujtoi idhujt që adhuronin dëgjuesit e tij, duke thënë se ata nuk ishin asgjë tjetër pos bestytini, idhuj të rrejshëm të trashëguar prej kohës së paraardhësve të tyre të cilëve ju mungonte çfarëdo prove e vërtetësisë. Ai shpjegoi se ishte mëkat



Stone carvings depicting the studies and books on the science of dream interpretation in Egypt and Mesopotamia during that period.

të adhurohej kushdo tjetër pos Allahut dhe se shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për këtë dhe pastaj i thirri në rrugën e drejtë.

Hapat e ndërmarrë nga Profeti Jusuf (as) sqarojnë mënyrën e shëndoshë të qasjes që duhet të përdoret kur njerëzve iu shpjegohet Islami. Duke e parë mundësinë që u paraqit në dëshirën e tyre për të prekur këtë temë, ai së pari shpjegoi atë për çka dëshironte të fliste në hollësi. Pasi e bëri këtë, ai atëherë kaloi në dhënien e përgjigjes në pyetjet e tyre në lidhje me shpjegimin e ëndrrave të tyre:

O shokët e mi të burgut! Njëri prej ju dyve do t'i japë të pijë verë zotëriut të vet, e tjetri do të varet, kurse shpezët do të hanë nga koka e tij.



A bust of one of Prophet Yusuf's cellmates.

Çështja për të cilën kërkua shpjegim, ka marrë fund (kështu). E atij për të cilin e dinte se është i shpëtuar i tha: "Më përkujto mua te zotëriu yt". Por djalli e shtyri atë të harrojë ta përkujtojë te zotëriu i tij, dhe për këtë mbeti në burg disa vjet. (Sure Jusuf: 41-42)

Një vështrim i kujdesshëm i ajetit të dytë tregon se Profeti Jusuf (as) u soll në të vërtetë në mënyrë shume të mençur. Pasi që foli për interpretimin e ëndrrave të tyre, ai i tha njërit prej dy shokëve të tij të qelisë që do të shpëtonte që t'ia përkujtonte atë zotëriut të tij. Kjo ishte një strategji shumë mendjemprehtë që për qëllim kishte të siguronte lirin e tij nga burgu. Sidoqoftë Profeti Jusuf (as) ishte gjithashtu i vetëdijshëm se ekzistonin kufijtë deri



One day, the ruler wished to have one of his dreams interpreted. He sought out the most reputable seers and wise men in the country. The incident is depicted in the picture above.

ku ai mund të arrinte dhe se ai do të dilte nga burgu vetëm atëherë kur Allahu të dëshironte.

Në të vërtetë, siç mund të shihet në pjesën e fundit të vargjeve të cituara më lartë, shejtani bëri që ai person ta harronte Profetin Jusuf (as), i cili kaloi shumë vite i burgosur. Mirëpo, profeti gjithashtu e dinte se ky ishte përfundimi më dobiprurës. Kjo në të vërtetë ishte një sprovë që thërriste në durim dhe nuk ka dyshim se kalimi i shumë viteve në burg dhe madje të qenit i harruar do të ishte një gjë shumë e vështirë për shumicën e njerëzve. Mirëpo Profeti Jusuf (as) këtu vërteton superioritetin e vlerave të tij morale dhe besimin e tij, duke mirëpritur çdo gjë që i ndodhi atij me nënshtrimin e tij të plotë ndaj vullnetit të Allahut.

ZBULOHET KOMPLOTI KUNDËR PROFETIT JUSUF (AS)



When the most famous seers and wise men in the country failed to interpret the ruler's dream, Prophet Yusuf's cellmate who had been released from prison remembered Yusuf (as) and suggested his lord visit the prison to meet him. This is depicted in the relief above and the painting below.



Siç rrëfëhet në Kuran, Profeti Jusuf (as) kaloi shumë vite në burg. Megjithatë, një ditë sunduesi shfaqti dëshirën që t'i interpretohej njëra prej ëndrrave të tij. Parashikuesit më të njohur dhe njerëzit më të urtë në vend u thirrën për këtë qëllim. Mirëpo, ata të gjithë thanë se ëndrra e sunduesit ishte shumë e paqartë dhe nuk ishin në gjendje ta interpretojnë. Mirëpo, pak kohë më vonë, njërit prej ish shokëve të qelisë së Profetit Jusuf (as) iu kujtua ai:

***E (kur u afrua lirimi i Jusufit) mbreti tha:
"Kam parë ëndërr shtatë lopë të majme dhe***

shtatë lopë të dobëta që i hanin ato (të dobëtat, i gëlltitën ato të majmet) dhe shtatë kallinj të gjelbër (që kishin lidhur frytin) e (shtatë) të tjerë të tharë. O ju pari, nëse dini të interpretoni ëndrrën, më tregoni për ëndrrën time!"
Ata (paria) thanë: "Ëndrra të përziëra, e ne nuk dimë komentimin e ëndrrave të tilla". E ai prej atyre dyve që shpëtoi (që i pat thënë Jusufi ta përmendë) e përkujtoi pas një periudhe e tha: "Unë ju tregoj kuptimin e saj. Pra më lejoni të shkoj (te Jusufi)". (Sure Jusuf: 43-45)

Duket se ngjarjet u shpalosën në mënyrë plotësisht të papritur dhe se Profeti Jusuf (as), i cili ishte harruar në burg për një kohë aq të gjatë, më në fund ishte kujtuar. Në të vërtetë ishte e shkruar në fatin e Profetit Jusuf (as) se për të do të kujtoheshin vetëm pasi të kishin kaluar shumë vite, që është edhe arsyeja pse ngjarjet morën këtë rrjedhë. Ishte Allahu i Cili ia dërgoi sunduesit ëndrrën e tij në dukje të paqartë, frymëzoi tek ai dëshirën që t'i interpretohej ëndrra atij, nuk e lejoi askënd ta interpretoj atë në mënyrë të kënaqshme dhe bëri që ish të burgosurit t'i kujtohej Profeti Jusuf (as). Allahu kishte paracaktuar të gjitha këto më parë. Kurani vazhdon të përshkruaj se si u shpalosën ngjarjet:

(E dërguan te burgu, e ai tha) O Jusuf, o ti i drejti, na shpjego për shtatë lopë të dobëta që i hanin shtatë lopë të majme, dhe shtatë kallinj të gjelbër e shtatë të thatë, e ndoshta po kthe-



The interpretation of the Egyptian ruler's dream by Prophet Yusuf (as) as depicted in various Christian sources.




The King declared, "I dreamt of seven fat cows which seven thin ones ate and seven green ears of wheat and some others which were dry..."
(Surah Yusuf: 43)

hem te njerëzit (me përgjigje), ashtu që edhe ata të kuptojnë (vlerën dhe dijen tënde)! (Sure Jusuf: 46)

Mënyra se si shoku i tij i qelisë iu drejtua Profetit Jusuf (as) është me interes të veçantë, "O Jusuf, o ti i drejti..." Nga kjo shprehje mund të shohim se njerëzit lehtësisht mund të kuptonin ndershmërinë dhe sjelljen e këndshme të një besimtari të vërtetë që e karakterizonte Profetin Jusuf (as). Si çdo profet, sjellja e Profetit Jusuf (as) shprehte sigurinë e tij personale dhe frymëzonte siguri tek ata të cilët takoheshin me të. Ish shoku i tij i qelisë ishte i vetëdijshëm për aftësitë e tij dhe iu afrua atij duke e parë se ai ishte i sinqertë dhe i besueshëm. Kur ata u takuan, ai kërkoi interpretimin e ëndrrës së sunduesit. Profeti Jusuf (as) e interpretoi ëndrrën më këto fjalë:

Ai (Jusufi) tha: "Mbillni shtatë vjet vazhdimisht, e çka keni korrur lëni në kallinj, përveç një pakice nga e cila do të hani. Pastaj, do të vijnë shtatë (vjet) të vështira (me skamje) që do ta hanë atë që e keni ruajtur për to, përveç një pakice nga ajo që do ta ruani (në depo për farë). Mandej, pas asaj vjen një vit (i begatshëm) në të cilin njerëzve u bie shi dhe në të cilin do të kenë të vjela (vit i begatshëm në përgjithësi)". (Jusuf: 47-49)

Kur sundimtari mësoi për mënyrën se si Profeti Jusuf (as) kishte interpretuar ëndrrën e tij ai e thirri atë të vinte tek ai. Kur la-



Representations of the Egyptian ruler of the time.

jmëtari i sundimtarit erdh te Profeti Jusuf (as), profeti përdori një strategji shumë të zgjuar. Në mënyrë që të dilte në shesh se ai ishte hedhur në burg dhe kishin shpifur të pavërteta për të edhe pse ai ishte plotësisht i pafajshëm dhe që e vërteta të zbulohej, në vend se t'i bindej thirrjes së tij menjëherë, ai e ktheu mbrapsht lajmëtarin tek sundimtari me një varg pyetjesh që do të ndikonin që kjo çështje të shqyrtohej përsëri. Ai kërkoi të mësonte për gratë që kishin prerë duart e tyre, të cilat ishin dëshmitare të pafajësisë së Profetit Jusuf (as) dhe të pandershmërisë së gruas së Azizit. Ato të gjitha ishin dëshmitare të shkallës së parë, ndonëse më parë nuk kishte ekzistuar një mjedis i tillë në të cilin ato do të mund të dëshmonin. Për atë arsye, Profeti Jusuf (as) shfrytëzoi këtë mundësi në mënyrën më të mençur. Ngjarja përshkruhet si në vijim:

E mbreti tha: "Më sillni mua atë (Jusufin)!"

Dhe kur i shkoi atij (Jusufit) i dërguari (i mbretit), ai (Jusufi) i tha: "Kthehu te zotëriu yt dhe pyete atë se si është puna e grave, që i

prenë duart e tyre? Vërtet, Zoti im e di shumë mirë dredhinë e tyre". (Sure Jusuf: 50)

Si përgjigje në pyetjen e Profetit Jusuf (as), sundimtari mblodhi bashkë gratë dhe i pyeti për të vërtetën në lidhje me këtë çështje:

Ai (mbreti) tha: "Çka ishte puna juaj kur ju vetë e dëshiruat (iu vërsulët) Jusufin?" Ato thanë: "Zoti na ruajt! Ne nuk dimë ndaj tij asnjë të keqe!" Gruaja e ministrit tha: "Tash doli në shesh e vërteta, e unë iu vërsula atij me dashuri, e ai është nga të drejtit!" (Sure Jusuf: 51)

Pas aq shumë vitesh e vërteta më në fund doli në shesh. U kuptua se gratë kishin ngritur një kurth për Profetin Jusuf (as) dhe se ai kishte vepruar me ndershmëri përballë propozimit të pahijshëm të gruas. Mirëpo, vitet që ai kishte kaluar në burg, ndonëse pafajësia e tij ishte fare e qartë, nuk ishin assesi humbje apo fatkeqësi. Allahu kishte planifikuar secilin moment që ai kishte përjetuar dhe ai plan përmbante mëshirë dhe mirësi të madhe. Të qenit në burg kishte shërbyer si mjet për edukimin shpirtëror të Jusufit (as) dhe që ai të edukohej mirë dhe të arrinte pjekurinë. Ai u afrua më pranë Allahut përmes qëndrimit të tij tërheqës. Të gjitha hallet dhe vështirësitë e kësaj bote shpërblehen në botën e përtejme (ahiret). Allahu u premton atyre prej robërve të tij që janë të durueshëm përballë vështirësive në këtë botë, atyre që i nënshtrohen Atij dhe janë falënderues, madje edhe në

rrethanat më të vështira, një jetë të këndshme në jetën e përtejme dhe kënaqësinë e Tij.

Veç kësaj, koha që Profeti Jusuf (as) kaloi në burg ishte gjithashtu një mjet për edhe një tjetër çështje të mbarë, pasi që Allahu ashtu kishte paracaktuar mjedisin politik në Egjipt që u bë një mjet përmes të cilit ai pat mundësi të vinte në pushtet.

Kur i hedhim një vështrim ngjarjes së ardhshme në këtë tregim, shohim se pasi që gratë dëshmuan të vërtetën Profeti Jusuf (as) i tha ndërmjetësit:

Këtë (e bëra thotë Jusufi) për ta ditur ai (ministri) se unë nuk e tradhtova tinëzisht dhe se vërtetë Allahu nuk realizon dredhinë e tradhtarëve. Unë nuk e shfajësoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë. (Sure Jusuf: 52-53)

Momenti më mahnitës këtu është se Profeti Jusuf (as) prapë i përkujtoi ata përreth për Allahun. Ai tha se Allahu kurrë nuk lejon planet tradhtarë të atyre që ngritin kurthe dinake të kenë sukses dhe se Ai bën që e vërteta të dal përfundimisht në sipërfaqe. Kjo është një gjë e rëndësishme, sepse shpifjet kundër Profetit Jusuf (as) dolën në shesh me lejen e Allahut. Sundimtari dhe njerëzit mësuan të vërtetën në momentin dhe mënyrën që dëshiroi Allahu. Fati që Allahu përcaktoi u jetësua dhe shkaktoi skenarin më të mirë dhe më të përshtatshëm.

Mirëpo ajo që Profeti Jusuf (as) thotë në vargun e mësipërm është gjithashtu më se e rëndësishme. Pavarësisht nga

fakti se e vërteta u shfaq haptazi, se ai ishte viktimë e një shpifjeje të qartë, se kaloi shumë vite në burg dhe se ishte një rob i ngritur në shkallën e profetit nga Allahu, Profeti Jusuf (as) nuk u përpoq të mohonte cenueshmërinë e epsheve të tij. Ai po ashtu zbuloi edhe një të vërtetë më se të rëndësishme këtu: “Epshi me të vërtetë urdhëron në vepra të liga – përveç atë që ka mëshiruar Zoti im...” Kjo është një gjë që besimtarët duhen ta kenë parasysh në secilin moment të jetës së tyre. Kjo për arsye se çdo qenie njerëzore ka dëshira tokësore dhe të gjithë njerëzit sprovohen në çdo moment gjatë jetës së tyre. Epshtet e njeriut ndonjëherë mund të bien ndesh me ndërgjegjen e tij dhe njeriu do të dëgjoj njërën apo tjetrën. Besimtarët bëjnë përpjekje të mëdha me vendosmërinë më të madhe që të jenë të vëmendshëm ndaj ndërgjegjeve të tyre që i thërrasin ata drejt asaj me të cilën Allahu është i kënaqur, ndërsa njerëzit e tjerë jetojnë në mëshirën e dëshirave të tyre.

Nëse një besimtar humbet nga shikimi detyrat e tij dhe iu dorëzohet dëshirave të tij duhet të pendohet dhe të jetë më vigjilent ndaj të këqijave të këtyre dëshirave. Kjo për arsye se, siç na ka bërë me dije Allahu në Kuran përmes fjalëve të Profetit Jusuf (as), dëshirat tokësore gjithmonë e urdhërojnë njeriun të kryej veprime të shëmtuara.



KOHA QË JUSUFI (AS) KALOI SI GUVERNATOR NË EGJIPT

PROFETI JUSUF (AS) FITON PUSHTET DHE NDIKIM

Pasi që sundimtari kishte mësuar të vërtetën filloi një periudhë e re për Profetin Jusuf (as). Sundimtari u tha njerëzve të tij t'ia sjellin Jusufin (as) dhe kur ai mbërriti ai i dha atij një pozitë të rëndësishme pranë tij, duke e bërë atë këshilltar të besueshëm të tij. Kjo rrëfëhet në Kuran si vijon:

Mbreti tha: "Ma sillni mua atë, thjeshtë ta veçoj për veten time!" (ia sollën Jusufin) E pasi që bisedoi me të tha: "Tash ti ke pozitë dhe je i besueshëm". Ai (Jusufi) tha: "Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm". Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt) që të jetonte aty ku dëshironte. Ne e pajisim me të mira tona atë që

duam, e Ne nuk ua humbim shpërblimin punëmirëve. Po shpërblimi i botës tjetër, gjithsesi është shumë më i mirë për ata që besuan dhe ata që u frikësuan dhe u ruajtën. (Sure Jusuf: 54-57)


Për të rikujtuar, Profeti Jusuf (as) kishte shkuar në Egjipt si rob, pas kësaj ai ishte futur në burg nën akuzën e shëmtuar dhe të pabazë se ishte dhënë pas epshit ndaj një gruaje. Mirëpo, Allahu bëri që të ndodhte një ndryshim që do të dukej “i pamundshëm”, duke e bërë Profetin Jusuf (as) një njeri fjala e të cilit kishte vlerë në qeverinë Egjiptiane. Tejkalimi i asaj që në shikim të parë mund të duket krejtësisht i pamundur, i takon sferës së urtësisë dhe pafundësisë së Allahut. Siç njoftohemi në Kuran: “**Sa e sa grupe të**



According to ancient Egyptian sources, rulers would give the people they appointed to run the treasury a ring such as this. Prophet Yusuf (as) was very probably given a ring like this as a symbol of his power and rank.

He said, "Sow for seven years in the normal way and leave that which you harvest in the ear except for a small amount from which you eat. Then after that seven hard years will arrive in which you can eat from what you set aside for them, except for a little which you store. Then after that another year will come in which the people will be helped by rain in plenty and when they once more will press."

(Surah Yusuf: 47-49)



The ancient Egyptian pictures above depict the seven years of plenty before the famine.



Images of agricultural land before and during the famine from a film about the life of Prophet Yusuf (as).



A wall relief depicting the starving people of Egypt.



The ancient Egyptian inscriptions from 1700-1550 BC describe in great detail the seven years of famine during the time of Prophet Yusuf (as).

vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!” (Sure Bekare: 249)

Si një mrekulli e besimit për besimtarët, Allahu i shpëton ata prej situatave që duken shumë të vështira apo të pamundshme dhe iu kundërvihet atyre që e mohojnë Atë. E vetmja detyrë që i takon një besimtari është që kurrë të mos e braktis besimin e tij në premtimin e Allahut dhe që gjithmonë t’i nënshtrohet vullnetit të Allahut dhe të ketë besim në Të.

Për ata që jetojnë jetët e tyre të larguar nga feja, majat më të larta që ata mund të aspirojnë është të posedojnë fuqi dhe pushtet në këtë botë, të posedojnë prona dhe pasuri dhe të kenë ndikim në mënyrën se si shpenzohen ato. Ky është qëllimi për të cilin ata luftojnë dhe të cilit ata ia kushtojnë jetët e tyre. Mirëpo, siç kemi parë, Allahu liroi Profetin Jusuf (as) nga burgu dhe i dhuroi atij gjithë këto të mira përnjëherë. Këtu qëndron urtësia në përkujtimin nga Allahu të jetës së përtejme (ahiretit) në fund të këtij ajeti, menjëherë pasi Ai i kishte dhënë Profetit Jusuf (as) fuqi, pushtet dhe pasuri.

Në këtë mënyrë ne përkujtohem se pronat dhe posti të ndara në këtë botë nuk janë të rëndësishme dhe ne duhet t’i drejtojmë shikimet tona drejt jetës së përtejme. Megjithatë, në fjalinë e fundit të këtij ajeti, sikur që na përkujtohet kjo çështje dhe informohemi se shpërblimi që do të na jepet në jetën e përtejme do të jetë më i dobishmi, gjithashtu njoftohemi se kjo vlen për besimtarët dhe për ata që ndejnë frikërespekt ndaj Zotit. Prandaj është e pamundur për ata të cilëve u mungojnë këto karakteristika të shpresojnë për një shpërblim të këndshëm në jetën e përtejme. Në këtë mënyrë, Allahu kthen shikimin e njerëzve në drejtim të jetës së përtejme.



Historical paintings bringing to life the seven hard years of famine.



A relief and a painting showing the Egyptian government storing away part of the harvests from the years of plenty and the distribution of provisions during the time of famine.

Njerëzve u shfaqet edhe një fakt shumë i rëndësishëm në historinë jetësore të Profetit Jusuf (as). Allahu zbulon këtë në Kuran:

***E, pa dyshim se pas vështirësisë vjen lehtësimi.
Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Sure
Inshirah: 5-6)***

Siç njoftohemi në këtë sure, Allahu u premtonte besimtarëve se pas çdo sprove Ai ka siguruar lehtësim.

Jeta e Profetit Jusuf (as) është përplot me shembuj të tillë. Mënyra se si kishte shpëtuar kur e hodhën në pus dhe si ishte edukuar në një familje të mirë dhe mënyra se si ishte emëruar përgjegjës i Thesarit të shtetit pas daljes nga burgu janë të gjitha dëshmi se si Allahu çdo hall dhe vështirësi e pason me ngushëllim dhe lehtësi.

PROFETI JUSUF (AS) DHE VËLLEZËRIT E TIJ TAKOHEN PËRSËRI

Siç pamë, Profetit Jusuf (as) iu besua Thesari Shtetëror i Egjiptit. Pas një kohe të shkurt, vëllezërit që e kishin hedhur atë në pus erdhën në Egjipt me qëllim që të bënin tregti dhe erdhën tek ai, por nuk arritën ta njohin. Ai, në anën tjetër, menjëherë i njohu ata dhe përgatiti një plan shumë delikat. Ai u ofroi atyre furnizime dhe i siguroi ata për mikpritjen e tij bujare, duke llogaritur kështu se do të mund të ndikonte që ata të bënin atë që ai dëshironte. Në vargjet në vazhdim mund të shihet se qëllimi i tij i vërtetë ishte që në të vërtetë të merrte vëllain e tij më të ri:

Dhe (pas një kohe) erdhën vëllezërit e Jusufit e hynë tek ai, e ai i njohu ata, por ata nuk e njohnin. E pasi i furnizoi me të gjithë artikujt e nevojshëm (me barë drithi për të cilin kishin ardhur, etj), u tha: "Më sillni një vëlla tuajin që e keni nga baba, a nuk e vëreni se unë vërtet



Thanks to Prophet Yusuf's foresightful management, provisions were distributed in exchange for capital during the years of famine. People poured into Egypt to engage in trade. The painting above and the ancient Egyptian images to the right depict that trade.



u plotësoj barrën (peshojën) dhe se unë jam mikpritësi më i mirë!" E nëse nuk ma sillni atë (vëllain), ju nuk do të merrni tek unë barë drithi (për ushqim), e as mos iu afroni (vendit tim). (Sure Jusuf: 58-60)

Nga kjo mund të vërehet se Profeti Jusuf (as) i përkrahu ata në dëshirat e tyre duke ua bërë të qartë se ishte një njeri i drejtë. Kjo shkoi tamam sipas planit. Veç kësaj, ai ua bëri të qartë se nëse nuk do t'ia sjellin vëllain e tyre nuk do të fitonin atë për çka kishin ardhur dhe as që do të pranoheshin një herë tjetër. Në këtë mënyrë ai ngjalli tek ta një perspektivë shqetësuese të vështirësive të mundshme.difficulties.

Në të vërtetë, ndikimi i fjalëve të Profetit Jusuf (as) në vëllezërit e tij u vërejt menjëherë. Duke e ditur fuqinë dhe madhësitinë e tij ata ishin të bindur se fjalët e tij nuk ishin të kota dhe vendosën të bëjnë gjithçka që kishin në dorë për ta sjellë vëllain e tyre:

Ata thanë: "Ne do të përpiqemi për të (për ta marrë) te babai i tij dhe gjithsesi ne do të bëjmë atë!" (Sure Jusuf: 61)

Strategjia e përdorur këtu nga Profeti Jusuf (as) ishte shumë e zgjuar. Nëse ai nuk do t'iu kishte ofruar atyre një përfitim material në këtë mënyrë, nëse nuk do t'iu kishte imponuar një numër kushtesh, ka mundësi që ata s'do ta kishin bërë këtë me dëshirë dhe s'do ta kishin sjellë vëllain e tyre. Prandaj, Jusufi (as) nuk ia la gjërat rastësisë në tërësi, por përgatiti një plan të cilit ata



Years later, the brothers who had thrown Prophet Yusuf (as) into the well came into his presence again to take provisions. This painting depicts that moment.

s'mund t'i bënin ballë.

Përveç ndërmarrjes së gjithë këtyre masave të zgjuara, Profeti Jusuf (as) ndërmori edhe një hap tjetër për t'u siguruar mirë. Para se vëllezërit e tij të lëshojnë Egjiptin ai vendosi të hollat që mori prej tyre për furnizime fshehtë në ngarkesat e tyre. Duke iu dhënë atyre edhe furnizimet edhe të hollat që ata i kishin paguar ai u siguroi atyre edhe një tjetër përfitim material. Kjo ngjarje përshkruhet në këtë sure:

***Ai (Jusufi) djelmohave të tij shërbëtorë u tha:
"Vëni mallin e tyre (barrën që kishin sjellë për të blerë drithë) në barrët e tyre, ashtu që kur të kthehen te familja e tyre (t'i hapin barrët) ta njohin, e ndoshta do të kthehen sërish te ne".
(Sure Jusuf: 62)***

Këtu ka një grimcë të çmuar të mençurisë që besimtarët duhet ta nxjerrin nga ky varg i hapave të ndërmarrë; kur njeriu bën një marrëveshje me njerëz ndërgjegjes së të cilëve nuk mund t'i besohet dhe të cilët janë të luhatshëm në besim dhe në parime

morale, është e rëndësishme që të ndërmerren të gjitha masat e mundshme kundër mundësisë që ata të thyejnë marrëveshjen dhe për t'u siguruar se ata do të bëjnë atë që kërkohet prej tyre. Një besimtar nuk e lë në dorën e palës tjetër rrjedhën e ngjarjeve, me fjalë të tjera nuk ua lë iniciativën atyre që janë të dobët në besim..

VËLLEZËRIT IA BËJNË NJË KËRKESË BABAIT TË TYRE

Një fakt i mirënjohur është se karakteristikë e njerëzve të paditur është lidhja e tyre e thellë me gjërat materiale dhe mënyra se si ata i përkulen çdokujt dhe çdo gjëje që mund të sjellë përfitime për ta. Vëllezërit e Jusufit (as) s'mund as të paramendonin të humbnin mundësitë materiale që ai u kishte ofruar. Posa lanë Egjiptin ata shkuan tek babai i tyre dhe e lutën atë t'ua jepte vëllain e tyre të vogël, duke i premtuar se do ta mbrojnë atë:

E kur u kthyen te babai i tyre thanë "O baba ynë, po na ndalohet barra (drithi), lejoni të vijë me ne vëllai ynë (Binjamini) që të marrim ushqim, e ne do ta ruajmë atë (nga çdo e keqe)". (Sure Jusuf: 63)

Megjithatë, babai nuk u besoi atyre:

Ai (Jakubi) tha: "A t'u besoj për këtë, vetëm sikurse u besova më parë për vëllain e tij (Jusufin), po Allahu është mbrojtësi më i mirë dhe Ai është mëshirues i mëshiruesve". (Sure Jusuf: 64)

Një vështrim i vëmendshëm do të zbulojë se si Profeti Jakub (as) ashtu edhe Profeti Jusuf (as) përgjithësisht përkujtonin dhe lavdëronin Allahun pasi që flisnin. Ky është një shembull për besimtarët, që tregon se ata duhet ta përkujtojnë Allahun gjatë gjithë kohës dhe kurrë të mos e harrojnë Atë.

Por, vëllezërit e Profetit Jusuf (as) posedonin një dëshirë të fortë për përfitim material. Për këtë arsye, ata bënë gjithçka që ishte e mundur për ta bindur babanë e tyre:

TE kur i hapën barrët e tyre, e gjetën mallin e tyre që iu ishte kthyer dhe thanë: "O ati ynë, çka duam më tepër! Ja, ky është malli ynë që na u kthye, do të furnizojmë me drithë familjen tonë, do ta ruajmë vëllain tonë dhe do ta shtojmë një barrë deveje, e kjo është sasi e lehtë (për sundimtarin)". (Sure Jusuf: 65)

Pasi që Profeti Jakub (as) nuk u besonte djemve tjerë të tij ai kërkoi prej tyre që t'i premtonin se do ta kthenin vëllain e tyre:

Ai (Jakubi) tha: "Unë kurrsesi nuk e dërgoj atë me ju, derisa të ma jepni besën (e fortë) në Allahun, se gjithsesi do të ma ktheni atë mua, përveç nëse u diktojnë rrethanat e nuk mundeni". E kur ata ia dhanë besën (u betuan), ai tha: "Allahu është garantues për këtë që e thamë". (Sure Jusuf: 66)

Vërejtja që Profeti Jakub (as) bëri se Allahu ishte dëshmi-

tar i kësaj marrëveshjeje dhe se ai e bëri Allahun Mbrojtës të tij janë shembuj të rëndësishëm të urtësisë. Kjo na tregon se të kërkossh prej njerëzve që janë të dobët në besim të betohen në emër të Allahut është një mjet i efektshëm për t'i udhëzuar ata drejt asaj që është më e mirë për ta, kjo për arsye se nëse ata ndajnë qoftë edhe pak frikërespekt ndaj Allahut do ta kenë këtë në mendje dhe do të sillen në mënyrë të ndershme.

Pasi që kishte shkëputur njëfarë premtimi prej fëmijëve të tij, Profeti Jakub (as) iu tha të veprojnë me kujdes dhe të hynë në Egjipt nëpër hyrje të ndryshme:

Po ai (Jakubi) tha: "O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) për një derë, po hyni nëpër dyer të ndryshme. Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i Allahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t'i mbështeten ata që besuan. (Sure Jusuf: 67)

Kjo këshillë që Profeti Jakub (as) iu dha të bijve të tij është tejet e rëndësishme. Këto vargje tërheqin vëmendjen ndaj faktit se besimtarët duhet gjithmonë të veprojnë me kujdes, të llogarisin çfarëdo rreziku të mundshëm dhe të ndërmarrin masa të duhura paraprake.

Mirëpo, në të njëjtën kohë, Profeti Jakub (as) na përkujton për thelbin që qëndron pas çdo gjëje. Ai thotë se është Allahu Ai që vendosë për këtë, se nëse Allahu dëshiron diçka nuk ka mënyrë të ndalohet ajo dhe se është e domosdoshme që t'i nënshtrohemi vullnetit të Tij. Këto janë vërejtje tejet të vlefshme. Këtu

mund të vërehet ideja e nënshtrimit ndaj vullnetit të Allahut të cilën Myslimanët duhet ta përvetësojnë në kuptimin e saj më të plotë. Mendimet e përhapura të fatit dhe nënshtrimit janë në të vërtetë të gabuara. Ka njerëz që mendojnë se gjërat ndodhin për shkak të masave që ata kanë ndërmarrë, ose se ata mund të bëjnë që të ndodhin gjëra tjera. Të tjerët kanë një pikëpamje të gabuar të nënshtrimit ndaj vullnetit të Allahut, në pajtim me: “Ajo që do të ndodhë është tashmë e paracaktuar, kështu që nuk ka nevojë që ne të bëjmë çfarëdo.” Të dyja janë të gabuara. Njerëzit janë përgjegjës për ndërmarrjen e masave të duhura në çfarëdo situatë me të cilën ndeshen, për t’i vënë gjërat në lëvizje, por të mos harrojnë se përfundimi është në duart e Allahut. Natyrisht se masat paraprake nuk do ta përcaktojnë përfundimin e asgjëje, prapseprap ato duhet të merren me kujdes dhe në mënyrë të ndërgjegjshme si një veprim i besimit.

Profeti Jakub (as) ishte besimtar i kompletuar dhe ishte plotësisht i vetëdijshëm për këtë fshehtësi. Mënyra se si ai i drejtohej Allahut kurdoherë që fliste dhe merrte parasysh anën e fshehtë të gjërave është tregues i frikës së tij ndaj Allahut. Ne na tregohet në një varg se Profeti Jakub (as) ishte një shërbëtor i pajisur me dituri:

***Dhe ata hynë ashtu si porositi babai i tyre, po ajo nuk ishte gjë që do t'u ndihmonte asgjë nga caktimi i Allahut, përveç një dëshire të Jakubit që e kishte në vete dhe e kreu. Po ai (Jakubi) ishte i dijshtëm për te, ngase Ne e kemi mësuar për atë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.
(Sure Jusuf: 68)***

PROFETI JUSUF (AS) TAKOHET ME VËLLAIN E TIJ TË VOGËL

Vëllezërit e Profetit Jusuf (as) erdhën në Egjipt, duke sjellë vëllain e tyre të vogël dhe prapë erdhën tek profeti. Këtu, Profeti Jusuf (as) ndau vëllain e tij të vogël prej të tjerëve dhe ia zbuloi atij identitetin e tij të vërtetë:

E kur hynë te Jusufi, ai (Jusufi) e afroi pranë vete vëllain e vet (Binjaminin) dhe i tha: "Unë jam vëllai yt, e ti mos u pikëllo për atë që ata vepruan!" (Sure Jusuf: 69)

Prej fjalëve të Profetit Jusuf (as) duket se vëllezërit e tij kishin bërë gjëra të ndryshme për t'i shkaktuar atij vështirësi dhe shqetësim. Ky është edhe një tregues i asaj se si karakteret e tyre ishin shumë të larguara nga feja.

Pasi që u takua me vëllain e tij më të ri, Profeti Jusuf (as) bëri një lëvizje mjaft të zgjuar të afrimit të tij pranë vetes. Kështu ai shpëtoi vëllain e tij të vogël prej mundimeve që po i shkaktonin vëllezërit e tij. Zgjuarsia e Profetit Jusuf përshkruhet në Kuran me fjalët në vijim:

Then when he had supplied them with E kur i pajisi ata me pajimet e tyre, e vuri tasin (gotën) në barrën e vëllait të vet, e pastaj një thirrës thirri: "O ju devexhinj, ju jeni vjedhës!" U kthyen (devexhinjtë) dhe thanë: "Çka keni humbur?" (Shërbëtorët e sundimtarit) thanë:

"Kemi humbur tasin e sunduesit, e kush e sjell atë (tasin), ka (shpërblim) një barrë deveje (drithë). Unë vetë jam për këtë garantues!"
Ata (vëllezërit e Jusufit) thanë: "Pasha Allahun, ju e dini se ne nuk kemi ardhur për të bërë shkatërrime në tokë dhe nuk jemi vjedhës!" (shërbëtorët) Thanë: "Nëse jeni gënjeshtarë, çfarë duhet të jetë ndëshkimi i atij (që ka vjedhur)?" (Vëllezërit) thanë: "Dënimi i tij është, vetë ai (të robërohet) në barrën e të cilit gjendet. Kështu ne i dënojmë të padrejtët!"
Ai (Jusufi) filloi (kontrollimin) në barrët e tyre, përpara barrës së vëllait të vet, e pastaj e nxori atë (tasin) nga barra e vëllait të vet. Kështu Ne e mësuaam të planifikojë Jusufi. Sipas ligjit të mbretit, atij (Jusufit) nuk i takonte ta ndalte (peng) vëllain e vet, përveç kur është dëshira e Allahut! Atë që duam Ne e lartësojmë shumë në dituri, e mbi secilin të dijshtëm ka edhe më të dijshtëm. (Sure Jusuf: 70-76)

Sipas ligjeve të Egjiptit, Profetit Jusuf (as) nuk i takonte të mbante vëllain e tij pranë vetes, mirëpo ai ishte në gjendje ta bënte këtë duke iu falënderuar planit që vuri në veprim. Sipas këtij plani, ai fshehu një kupë në plaçkat e vëllait të tij. Njëri prej njerëzve të tij pastaj i thirri ata në mënyrë të tillë për t'i vënë ata në një gjendje psikike të fajësisë dhe alarmit. Përveç kësaj, u deklarua se kupa i



Pictures showing the ruler's lost goblet being found in the baggage of Prophet Yusuf's brother.

takonte sundimtarit dhe se kushdo që e gjente do t'i jepej një barrë e plotë deveje (me drithë) si shpërblim. Kështu u krijua përshtypja se ky ishte një incident madhor, duke parandaluar në këtë mënyrë çfarëdo dyshimi se e gjithë kjo ishte një dredhi e bërë me qëllim.

Tek më vonë, ai i pyeti ata se çfarë mund të ishte dënimi nëse do të zbulohet se kupa ishte në posedimin e tyre. Sipas ligjit, pronari i thesit në të cilin do të gjendej kupa do të ndalohej dhe do të mbahej në arrest.

Mirëpo për të mos e bërë të dukshme se e gjithë kjo ishte një dredhi, ai nuk shikoi së pari në plaçkat e vëllait të tij të vogël, por filloi t'i kontrolloj plaçkat e të tjerëve. Kur kupa u gjend në plaçkat e vëllait të tyre të vogël, të tjerët menjëherë e pranuan këtë situatë dhe e akuzuan atë se ishte një hajn dhe përsëritën një shpifje të mëhershme në lidhje me Profetin Jusuf (as):

(Vëllezërit) thanë: "Në pastë vjedhur ky, ka pas vjedhur më parë edhe një vëlla i tij."...(Sure Jusuf: 77)



The moment the goblet was found, from a film about the life of Prophet Yusuf (as). Under normal circumstances Yusuf (as) would not have been unable to keep his brother by him, yet the plan he conceived enabled him to do this.

Mirëpo, vëllezërit e tij në të vërtetë e dinin shumë mirë se ai nuk do të kishte vjedhur, se ai ishte një person i ndershëm. Sipas standardeve morale të përcaktuara në Kuran, besimtarët duhet të kenë mendim të mirë për njëri tjetrin dhe të mbrojnë njëri tjetrin prej shpifjeve. Fakti se vëllezërit e Profetit Jusuf (as) nuk e mbrojtën vëllain e tyre të ri të pafajshëm dhe faktikisht e implikuan këtu edhe vet profetin, është tregues i karaktereve të tyre të rrejshme dhe dyfytëshe.

Profeti Jusuf (as) u soll me durimin më të madh përballë kësaj situatë:

(Vëllezërit) thanë: "Në pastë vjedhur ky, ka pas vjedhur më parë edhe një vëlla i tij." Jusufi këtë e mbajti fshehtë në vete e nuk ua zbuloi

atyre dhe tha: "Ju jeni në pozitë më të keqe (këtë e tha me vetvete e jo atyre), Allahu e di më së miri për atë që ju trilloni." (Sure Jusuf: 77)

Qëndrimi i Profetit Jusuf (as) këtu është shembull si i bindjes ndaj Allahut ashtu edhe i një zgjuarsie të madhe. Shumica e njerëzve të paditur zemërohen kurdo që dëgjojnë fjalën më të vogël të folur kundër tyre dhe reagojnë në mënyrë emocionale. Mirëpo, Profeti Jusuf (as), mbajti mendimet e tij të fshehta, siç na rrëfejnë vargjet, me fjalë të tjera, ai nuk lejoi që ndjenjat e tija intime të kuptohen prej të tjerëve. Ngjarjet që vijojnë rrëfohen më poshtë:

Ata thanë: "O zotëri, ai ka një babë shumë të vjetër, pra, në vend të tij na merr njërin prej nesh. Bëje këtë të mirë se ti je prej atyre që bëjnë mirë!"

Ai (Jusufi) tha: "Allahu na ruajt, të marrim tjetër pos atij te i cili e kemi gjetur mallin tonë, ne atëherë do të jemi të padrejtë!" E kur e humbën shpresën prej tij, u veçuan për t'u konsultuar. Më i madhi i tyre tha: "A nuk e dini që babai juaj ka marrë prej jush besën në Allahun, e më parë çfarë padrejtësish keni bërë ndaj Jusufit?" Unë pra nuk ndahem kurrë prej kësaj toke (Egjiptit) deri sa të më lejojë babai im, ose të vendosë Allahu (mirë) për mua, e Ai është gjykatësi më i drejtë! (Sure Jusuf: 78-80)

Këtu shihet se njëri prej vëllezërve të Profetit Jusuf (as) ishte pak më i ndërgjegjshëm se të tjerët. Në të vërtetë, një situatë e tillë ishte shfaqur në kohën kur Profeti Jusuf (as) u hodh në pus dhe shumica e vëllezërve të tij deshën ta mbytin atë, në çka njëri prej tyre tha: "Mos e mbytni Jusufin, e në qoftë se jeni për të bërë diç, lëshojeni atë në fund të pusit, do ta marrë atë dikush prej udhëtarëve". (Jusuf: 10). Ndoshta këta të dy janë në të vërtetë një i njëjti person (Allahu e di më së miri). Atë që ne po krahasojmë këtu është një karakter interesant njerëzor, një karakter ndërgjegjja e të cilit e bën të kuptoj se ajo që po ndodhë rreth tij është mëkatore, por që dështon t'iu kundërvihet këtyre ngjarjeve në masë të mjaftueshme dhe që është në gjendje vetëm të bëj një kundërshtim modest. Edhe pse ky është një model shumë më pozitiv se ai i njerëzve mizorë pa kurrfarë ndërgjegje, akoma është tejet i pamjaftueshëm dhe i mangët kur të krahasohet me karakterin e një besimtari të sinqertë.

Karakterin e besimtarit është karakter që kërkon ndërhyrje të atypëratyshme dhe të menjëhershme kur vëren sjellje që është në kundërshtim me fenë e Allahut, apo vrazhdësi, apo mungesë të vetëdijes. Besimtari kurrë nuk është i paaftë, kurrë nuk bie nën ndikimin e "psikologjisë së grupit" apo nën ndikimin e shumicës mizore përreth tij dhe kurrë nuk bën kompromise për atë që është e drejtë. Ai kurrë nuk do t'i shmanget rrugës së Allahut, madje edhe nëse të gjithë përreth tij i shmangen.

Biseda në mes të vëllezërve të Profetit Jusuf (as) rrëfëhet në Kuran me këto fjalë:

Ju kthehuni te babai juaj dhe i thoni: "O ati ynë, djali yt vodhi, ne dëshmojmë vetëm për

atë që dimë, e për të fshehtën ne nuk ishim roje!" Ti dërgo e pyeti (banorët në) qytetin ku ishim ne, po ashtu edhe (ata me) karvanin me të cilin kemi ardhur. Ne jemi të drejtë (ç'të themi). Ai (Jakubi) tha: "Jo, çështjen ua lehtësoi epshi juaj. (mua nuk më ka mbetur tjetër) Durim i mirë, është shpresë që All-llahu do të m'i sjellë të gjithë; Ai është më i dijshtëmi, më i urti!" (Sure Jusuf: 81-83)

Kur e shqyrtojmë me vëmendje, vëllezërit me të vërtetë besuan se vëllai i tyre i vogël kishte vjedhur. Mirëpo siç kemi parë tashmë, ishte një gabim i rëndë i tyre të mendojnë kështu. Ata duhej ta dinin se një besimtar kurrë nuk do të bënte një gjë të tillë dhe duhej të kishin mendimin më të mirë për vëllain e tyre dhe të pandehnin se kishte ndodhur ndonjë gabim. Në të vërtetë, Profeti Jakub (as) u soll mu në atë mënyrë që mund të pritej prej një besimtari. Ai kurrë nuk pranoi as edhe mundësinë më të vogël se djali i tij mund të ishte hajn, meqenëse e dinte se ai ishte besimtar, njeri që kishte frikë prej Allahut. Pos kësaj, pasi që ishte i vetëdijshtëm se parimet morale të djemve tjerë të tij ishin tejet të largëta nga ato të fesë, ai refuzoi t'u besoi dhe supozoi se vet marrëveshjet e tyre të pandershme qëndronin në thelb të çështjes, se kjo ishte ndonjë dredhi e tyre. Nënshtrimi i Profetit Jakub (as) ndaj vullnetit të Allahut këtu është një tjetër shembull i sjelljes së drejtë që i ka hije një besimtar. Edhe pse ai besonte se ajo që i kishte ndodhur djalit të tij ishte ndonjë gabim dhe se ishte përdorur ndonjë dredhi, ai menjëherë iu drejtua Allahut dhe me durim kërkoi ndihmën e Tij.

Prapë, ai e bëri të qartë se ajo që i përshtatej atij ishte durimi. Profeti Jakub (as) kurrë nuk e humbi shpresën. Ai madje shpresonte se Allahu do ta ribashkonte atë me Jusufin (as) dhe djalin tjetër në një të ardhme të afërt.

Veç kësaj, besimi se në çdo gjë ka diçka të mbarë është një prej karakteristikave që më së shumti i karakterizojnë besimtarët. Se kishte diç të mbarë në besimin e vëllezërve se më i riu kishte vjedhur kupën, vërtetohet me faktin se ata u bindën lehtësisht që ta lënë vëllain më të ri në Egjipt pa i shkaktuar asnjë vështirësi Profetit Jusuf (as).

Profeti Jakub (as) në anën tjetër, e dinte këtë fshehtësi, domethënë, se Allahu krijoi gjithçka dhe i bëri të favorshme për besimtarët. Në të vërtetë, aspekti që më së shumti bie në sy i qëndrimit të tij është mënyra se si ai nuk i lidhë ngjarjet me shkaqet materiale, nuk mendon me një logjikë sipërfaqësore të shkakut dhe pasojës dhe e din se çdo gjë është padyshim nën kontrollin e Allahut. Ky shembull tregon se besimtarët kurrë s'duhet ta braktisin shpresën e tyre në Allahun, pa marrë parasysh se çka ndodhë, pa marrë parasysh se sa janë të vështira rrethanat. Ata duhet gjithmonë të jenë përplot shpresë dhe t'i drejtohen Allahut për ndihmë.

Mirëpo, Profeti Jakub (as) ishte në një situatë interesante. Pavarësisht nga ajo se e dinte se Allahu krijoi çdo gjë, ai nuk ngurronte të ndjente pikëllim për Profetin Jusuf (as) dhe vëllain e tij. Kjo ishte një sprovë për të. Kjo përvojë ishte në të vërtetë një sprovë aq e madhe, sa që siç zbulohet në Kuran, sytë e tij u zbardhën nga pikëllimi për Profetin Jusuf (as), domethënë, ai u verbua. Djemtë e tij e paralajmëruan se ai mund të sëmurej për shkak të pikëllimit që ndjente, bile edhe të vdiste:

Dhe, ua ktheu shpinën e tha: "O dëshpërimi im për Jusufin, dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, po i përmbajtur (nga pikëllimi). Ata thanë: "Për Allahun ti vazhdimisht e përkujton Jusufin derisa do të sëmuresh rëndë, e të shkatërroresh". Ai (Jakubi) tha: "Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, e unë di për Allahun atë që ju nuk dini". (Sure Jusuf: 84-86)

Në këto vargje tregohet se pikëllimi mund të shpie në sëmundje të rëndë. Në të vërtetë, në shumë vende në Kuran, Allahu u thotë njerëzve që të mos ndiejnë pikëllim apo trishtim. Kur nuk respektohet kjo vërejtje, pasojat negative mund të vërehen menjëherë. Përveç pasojave psikike të pikëllimit, me vete gjithashtu sjellë pasoja të rënda fizike, si nxirje nën sy, tendosje në fytyrë, zbardhje të flokëve, dobësim trupor, etj.

Në vazhdim të kësaj ngjarje, Profeti Jakub (as) kërkoi prej djemve të tij të shkojnë dhe të sjellin lajme të reja për Profetin Jusuf (as) dhe vëllain e tij:

(Jakubi u tha të bijve të vet) O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, sepse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun. (Sure Jusuf: 87)

A picture showing Prophet Yusuf (as) revealing his true identity to his brothers. They remembered what they had done, repented and confessed their mistake.



Këtu vlen të përmendet fakti se Profeti Jakub (as) ishte i sigurt se Profeti Jusuf (as) ishte ende gjallë. Arsyeja për këtë siguri ndoshta mund të ketë qenë një dijeni e posaçme që Allahu ia dhuroi atij. Siç zbulohet në Kuran, Allahu është në gjendje që profetëve dhe të dërguarve të tij t'u dhuroj gjëra të tilla si perceptim të fuqishëm shqisor, urtësi të jashtëzakonshme, mendjehollësi të përkryer, largpamësi superiore dhe aftësi për të parë ngjarjet e së ardhmes. Për atë arsye është e domosdoshme të mbështetemi në ata të cilëve ju është dhënë një dijeni e tillë, t'ju besojmë dhe të veprojmë në përputhje me ta.

Një fakt tjetër që theksohet në këtë varg është se besimtarët duhet gjithnjë të jenë optimist në çfarëdo rrethana. Profeti Jakub (as) kurrë nuk nuk pushoi së shpresuari se do ta shihte Profetin Jusuf (as) dhe vëllain e tij dhe i këshilloi djemtë e tij që kurrë të mos e braktisin shpresën në Allahun. Humbja e shpresës në Allahun është një gjendje shpirtërore e përshtatshme për mosbesimtarët, jo për besimtarët.

PROFETI JUSUF (AS) NJIHET PREJ VËLLEZËRVE TË TIJ

Kurani përshkruan takimin e Profetit Jusuf (as) me vëllezërit e tij si në vazhdim:

(shkuan) E kur hynë tek ai i thanë: "O ti zotëri, neve dhe familjen tonë na ka goditur skamje e vështirë, e kemi ardhur me një mall të vjetër, e ti pra na mbush masën (barrën) dhe na dhuro, Allahu i shpërblen ata që dhurojnë". (Sure Jusuf: 88)

Qëndrimi i përvetësuar nga vëllezërit në fund të strofës së mësipërme vlen të përmendet në veçanti. Pasi që e lutën Profetin Jusuf (as) që të jetë bujar ndaj tyre, ata përkujtuan Allahun dhe faktin se Ai do t'i shpërblejë ata që japin me bujari. Ky është tregues i sjelljes së tyre dyfytyrëshe, pasi që përkundër asaj se jetonin në një mënyrë që është në kundërshtim me fenë dhe kënaqësinë e Allahut dhe të harruarit e Allahut nga ana e tyre gjatë veprimeve të tyre, kur interesat e tyre janë të rrezikuara ata e përkujtojnë Atë.

Fakti se Allahu i don ata që sinqerisht kërkojnë kënaqësinë e Tij zbulohet në Kuran dhe për këtë nuk ka dyshim. Në anën tjetër, ata që injorojnë atë që e kënaqë Allahun dhe i drejtohen Atij vetëm kur rrezikohen interesat e tyre, akoma mendojnë se mund të ndikojnë në të tjerët pavarësisht prej këtij qëndrimi.

Në vargun vijues Profeti Jusuf (as) i la të kuptojnë identitetin e tij pa marrë parasysh këtë lutje për ndihmë nga vëllezërit e



A Christian picture of the brothers regretting their past deeds.

tij, pa i vënë fare veshin asaj që ata thanë. Në këtë mënyrë ai ua mundësoi atyre që të kuptojnë kush ishte ai në të vërtetë:

Ai (Jusufi) tha: "A e dini çka keni bërë me Jusufin dhe vëllain e tij, kur ishit injorantë?" Ata thanë: "A ti je vetë Jusufi?" Ai tha: "Unë jam Jusufi, e ky është vëllai im, Allahu na dhuroi shpëtimin, pse ai që ruhet dhe bën durim, s'ka dyshim Allahu nuk humb shpërblimin e punëmirëve". Ata thanë: "Pasha Allahun, është e vërtetë se Allahu të ka lartësuar mbi ne, kurse ne vërtetë ishim fajtorë!" (Jusuf: 89-91)

Siç mund të shihet nga thëniet në këto vargje, vëllezërit e Profetit Jusuf (as) arritën të marrin me mend se kishin të bënë me vet Profetin Jusuf (as), duke deklaruar pendimin e tyre dhe faktin se ata kishin bërë gabim. Ata pranuan se Allahu e kishte dalluar Jusufin (as) dhe se Ai e kishte zgjedhur atë mbi të tjerët. Një çështje me rëndësi theksohet këtu: aftësia e të zgjedhurit i takon Allahut.

Ky fakt gjithashtu zbulohet në Kuran, në fjalët: **“Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë, atyre nuk u takon zgjedhja...”**

(Kasas: 68)

Profeti Jusuf (as) iu dha vëllezërve të tij përgjigjen vijuese:

Ai tha: "Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ju faltë juve; Ai është më mëshiruesi i mëshiruesve! (Jusuf: 92)

Siç mund të shihet nga vargu i mësipërm, përkundër faktit se Profeti Jusuf (as) ishte në situatë t’i ndëshkonte vëllezërit e tij apo të sillej me ta në mënyrë të keqe, ai nuk i mori në pyetje ata, por në vend të kësaj tha se ai nuk i dënonte ata. Në të vërtetë, ai madje luti Allahun që t’i falte ata, duke i përkujtuar se Allahu është më Mëshirëploti.

Kjo sjellje nga ana e Profetit Jusuf (as) është shembull për të gjithë besimtarët. Njerëzit e paditur frymëzohen me urrejtje në situata të tilla, dhe veprojnë me logjikën e hakmarrjes. Besimtarët, në anën tjetër, refuzojnë të këmbëngulin në të drejtat e tyre personale, siç ishte rasti me Profetin Jusuf (as), dhe e dinë se sjellja falëse pëlqehet në sytë e Allahut. Kjo është në pajtim me vargun: “T’i justifikoj njerëzit, të urdhëroj atë që është e drejtë dhe t’ju shmanget injorantëve.” (A’raf: 199). Ata falin sjelljen e ligë dhe dëshmojnë virtyte morale superiore duke iu kundërvënë të keqes me të mirë.

DIJENIA E PROFETIT JUSUF (AS)

Pasi që iu tha këto fjalë vëllezërve të tij, Profeti Jusuf (as) iu dha këmishën e tij, duke i lutur që t’ia dërgojnë babait të tyre:

Ju shkoni me këtë këmishën time, dhe hidhjani atë babait tim në fytyrë, e atij do t'i kthehet të pamët, e pastaj ejani tek unë me tërë familjen time". (U nisën) Dhe posa u ndanë devetë (prej qytetit), i ati i tyre tha: "Unë po e ndiej erën e Jusufit, mos më konsideroni të matufosur." (këtë ia tha familjes së vet në Palestinë). Ata (që ishin prezent) thanë: "Për Allahun, ti vërtet qëmoti je në humbje". (Sure Jusuf: 93-95)

Këto vargje dëshmojnë se familja e tij mendonte se Profeti Jakub (as) kishte bërë gabim për shkak se ishte përmalluar shumë për djalin e tij. Ekziston një mësim i urtë që duhet ta kemi në mendje që shfaqet nga ky qëndrim i tyre; shpesh është gabim të gjykohet në dritën e pamjeve dhe shkaqeve të jashtme. Kjo për arsye se Allahu ka folur në Kuran për veprimet që ndërmerren duke u bazuar në dijeninë e cila është dhuruar në mënyrë të veçantë. Për shembull, kjo çështje ilustron deri në një masë në ngjarjen e takimit të papritur të Profetit Musa (as) me një rob të Allahut të pajisur me dijeni të posaçme. (Për hollësi tjera, shiko Profeti Musa (as) të Harun Jahjasë, Qendra e Librit Millat, Qershor 2002). Sidoqoftë Allahu kishte shpallur se Profeti Jakub (as) ishte një rob i pajisur me dijeni të posaçme. Familja e tij nuk qe në gjendje të kuptoj sjelljen e tij të përvetësuar për shkak të kësaj dijenie dhe iu qasën çështjeve nga një perspektivë sipërfaqësore, duke besuar që ai ishte në gabim.

Në të vërtetë, pas marrjes së këmishës, Profeti Jakub (as)

përkujtoi familjen e tij për dijeninë e posaçme që i ishte dhënë atij:

***E kur erdhi myzhdexhiu, ia vuri atë
(këmishën) mbi fytyrën e tij, atij ju kthye të
pamët dhe tha: "A nuk ju thashë se unë di nga
Allahu çka ju nuk dini?" (Sure Jusuf: 96)***

Siç kemi parë, fjalët e folura më parë nga Profeti Jusuf (as) ndodhën; kur përshkuan me këmishë fytyrën e babait të tyre atij iu largua sëmundja dhe sytë e tij filluan të shohin prapë. Pra atij iu rikthye shëndeti. Veç kësaj, fjalët e Profetit Jakub (as) u bënë realitet. Ai kishte kuptuar dhe ndjerë që më parë se do ta shihte prapë Jusufin (as). Ky është një tregues i vërtetë se ata të dy ishin robër të pajisur me dijeni të posaçme.

ËNDRRA E PROFETIT JUSUF (AS) REALIZOHET

PROFETI JUSUF (AS) RIBASHKOHET ME FAMILJEN E TIJ

Kur Profeti Jakub (as) mori lajmin, bashkë me dëshminë që e mbështeste atë, se Jusufi (as) ishte gjallë, gënjeshtër që vëllezërit e tij e kishin mbajtur të fshehtë aq gjatë doli në shesh. Ata i kishin thënë babait të tyre se ai ishte mbytur dhe e kishin ngrënë ujëqit, ndonëse Jusufi (as) ishte në të vërtetë akoma gjallë. Kur kjo u kuptua, fëmijët e Profetit Jakub (as) e lutën atë t'i falte ata:

Ata thanë: "O baba ynë, lutu për neve të na falen mëkatet tona, se me të vërtetë ne kemi qenë fajtorë!" "Më vonë do t'i kërkoj Zotit tim faljen tuaj", tha ai (Jakubi), se vërtet, Ai është që falë, është mëshirues. (Sure Jusuf: 97-98)

Nëse e analizojmë me vëmendje, Profeti Jakub (as) tha se do të kërkonte falje jo menjëherë por në një kohë më të vonshme.

Pse të mos kërkonte Profeti Jakub (as) falje për bijtë e tij menjëherë? Ndoshta urtësia këtu qëndron në atë se ai dëshironte të shihnte se çfarë do të ishte sjellja dhe qëndrimi i tyre i pastajmë. Ndoshta kishte dëshirë të shihnte nëse ata me të vërtetë e kishin braktisur sjelljen e tyre të gabuar dhe nëse ishin me të vërtetë të sinqertë. Për këtë arsye, ndoshta ai do të lutej për ta kur të kishte formuar atë mendim (Padyshim se Allahu e di më së miri).

Sidoqoftë siç bëhet e qartë në fund të vargut, Profeti Jakub (as) i përkujtoi ata gjithashtu se Allahu është Ai që falë dhe është mëshirues. Ai e bëri këtë që ata të mund të shpresonin për falje prej Allahut dhe t'i drejtohen Atij me pendim të sinqertë.

Zhvillimet e pastajme rrëfohen në Kuran me këto fjalë:

(e morën familjen dhe shkuan) e kur hynë te Jusufi, ai i afroi pranë vetes të dy prindërit e tij dhe tha: "Me dëshirën e Allahut hyni në Egjipt të sigurt!" (Sure Jusuf: 99)

Gjëja e parë që Profeti Jusuf (as) bëri kur takoi familjen e tij ishte që t'i përqafonte ata dhe t'ju përkujtonte se ishin të sigurt. Nga ky varg mund të shihet se të përqafosh dikend është një shprehje e sinqertë e dashurisë. Të sigurosh dikend se janë të sigurt është një gjest i ndjeshëm që i bën ata të ndjehen të qetë. Kjo duhet të ketë ndikuar në mënyrë tejet qetësuese te këta njerëz që kishin bërë një udhëtim të gjatë dhe që kishin përjetuar peripeci të shumta për të kuptuar se tanimë mund të jenë të qetë dhe të ndjehen të sigurt. Kjo është një sjellje shembullore që besimtarët duhet të ndjekin. Të qetësosh një mysafir, një të huaj apo dikend nën kulmin tënd duke i siguruar ata se mund të ndjehen të lirë të gëzojnë

sigurinë dhe rehatinë e tokës apo shtëpisë së dikujt është një gjest i bukur ndaj të cilit tërhiqet vëmendja në Kuran.

As mikpritja e as ndjeshmëria e Profetit Jusuf (as) nuk përfunduan me këtë. Respekti që Jusufi (as) shfaqti për prindërit e tij përshkruhet në Kuran si vijon:

***Dhe ai të dy prindërit e vet i mori lart në fron
(i uli pranë vetes), e ata iu përrulën atij...(Jusuf:
100)***

Ulja e babait dhe nënës së tij në fron është një shprehje e hirshme e respektit. Ata ishin më të vjetër se ai dhe veç kësaj babai i tij ishte një profet të cilin Allahu e kishte forcuar me dijeni. Ata treguan një përrulje të madhe përballë sjelljes plot respekt të Jusufit (as).

Një vështrim i vëmendshëm zbulon se përkundër faktit se Profeti Jusuf (as) ishte djali i tyre dhe se ata ishin shumë më të vjetër se ai, ata u sollën me të me një përrulje të madhe. Në varg thuhet se familja e tij u përrul para tij. Kjo duhet të ketë qenë një shfaqje e respektit e përhapur gjithandej sipas zakoneve të asaj kohe, natyrisht se këtu nuk bëhet fjalë për kurrfarë “adhurimi”. Në mesin e njerëzve të paditur në rrethana të tilla krenaria ndërhyr dhe palët e përfshira ngurrojnë të sillen në mënyrë të sinqertë dhe me plot respekt. Në shoqëritë e paditura (injorante) njerëzit me fuqi i shmangen çfarëdo lloji të shprehjes së respektit siç është përkulja, në veçanti ndaj kujtdo që qëllon të jetë më i ri se ata. Mirëpo, sjellja e Profetit Jusuf (as) dhe e familjes së tij mbështetej në respekt, dashuri dhe përrulje. Ky është një ilustrim i qartë se si do të duhej të ishte një familje besimtare.

Në këtë atmosferë, Profeti Jusuf (as) pastaj përshkroi gjithçka i kishte ndodhur atij dhe zbuloi funksionimin e përkryer të planit të Allahut:

(e ai tha): "O ati im, kjo është domethënia e ëndrrës sime të mëparshme. Zoti im këtë tanimë e bëri realitet, e mua më dhuroi mirësi kur më nxori prej burgut, e juve u solli nga fshati pasi djalli pat futur përçarje ndërmjet meje dhe vëllezërve të mi. Zoti im, me mjeshtëri e butësi realizon dëshirën e vet për çka dëshiron, vërtet Ai është i dijshti, i urti. (Sure Jusuf: 100)

Do të rikujtojmë se Profeti Jusuf (as) kishte ëndërruar njëmbëdhjetë vje, diellin dhe hënën duke iu përkulur atij. Fakti se shumë vite më vonë gjendja e tij ishte e tillë që nëna e tij, babai dhe vëllezërit e tij treguan një respekt të madh dhe u përkulën para tij në shenjë respekti dhe fakti se vëllezërit e tij në veçanti erdhën tek ai kur kishin nevojë për të ishte përmbushje e asaj ëndrre.

Një vështrim i mëtejshëm prapë zbulon se gjersa Profeti Jusuf (as) ishte duke shpjeguar gjithë këtë, ai i drejtohej Allahut dhe lavdëronte emrin e Tij dhe shpjegoi gjithashtu se ngjarjet të cilat ai dhe familja e tij kishin përjetuar deri atëherë, të gjitha kishin ndodhur si pjesë e planit të Allahut. Ky është një lloj i të kuptuarit dhe të folurit shembullor që një besimtar duhet ta përvetësoj.

Një karakteristikë tjetër e Profetit Jusuf (as) që meriton të përmendet këtu është mënyra se si ai shihte anën pozitive të çdo gjëje dhe gjithçka shpjegonte në mënyrë të përshtatshme. Për shembull, ai tha se Allahu i kishte bërë atij një nder dhe e kishte

liruar nga burgu. Ky është në kuptimin e plotë të fjalës qëndrimi që i ka hije një besimtari dhe dëshmi se ai i shikonte gjërat me një besim pozitiv dhe optimist. Profeti Jusuf (as) pra e bëri të qartë se ai ishte në anën e Allahut dhe iu shmang çfarëdo mënyre të sjelljes apo të folurit që ishte negative apo jofalënderuese për çfarëdo që Allahu krijon. Fakti se ai tha: “Zoti im, me mjeshtëri e butësi realizon dëshirën e vet për çka don, vërtet Ai është i dijshti, i urti.” është dëshmi e kësaj. Në këtë mënyrë, Profeti Jusuf (as) shërben si shembull për të gjithë besimtarët.

PËRFUNDIM

LUTJA E SINQERTË E PROFETIT JUSUF (AS)

Kudo në këtë libër kemi diskutuar se sa jashtëzakonisht i devotshëm ndaj Allahut ishte Profeti Jusuf (as), sa mirë ishte ai i mbrojtur prej Tij, dhe sa shpesh ai i drejtohej dhe i falënderohej Atij. Kjo mund të shihet në vargjet vijuese në të cilat Allahu e frymëzon atë me fjalët në vazhdim:

(Pasi iu plotësua dëshira Jusufi tha) Zoti im, Ti më ke dhënë mua pushtet, më mësove mua komentimin e ëndrrave; o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestar imi në dynja e në Ahiret, më bën të vdes si Mysliman dhe më bashko me të mirët!" (Sure Jusuf: 101)

Siç kemi parë, Profeti Jusuf (as) ishte i vetëdijshëm se të

gjitha vetitë që ai posedonte, si të mirat materiale ashtu edhe dijeninë dhe arsyen e tij, i ishin dhuruar atij prej Allahut. Ata që mohojnë fenë e vërtetë, në anën tjetër, besojnë se ata sigurojnë çdo gjë përmes përpjekjeve të tyre, duke lartësuar kështu veten e tyre në sytë e tyre dhe duke treguar mosmirënjohje ndaj mirësive të Allahut.

Lutja e Profetit Jusuf (as) siç është shënuar në vargjet e mësipërme është një shprehje tjetër e besimit dhe frikës së tij ndaj Allahut. Përkundër asaj se ishte një profet i zgjedhur prej Allahut, ai dëshiron të vdes si besimtar dhe t'i bashkëngjitet shoqërisë së të drejtëve (të mirëve). Asgjë nuk merret si e sigurt sa i përket pozitës së tij në jetën e përtejme. Ai ndjenë frikë të sinqertë ndaj Allahut dhe i drejtohet Atij kur ka nevojë.

Kjo është ajo formë e të kuptuarit dhe sjelljes që i ka hije një besimtar. Ata që mendojnë se e meritojnë Kopshtin (Xhenetin), që pohojnë se si robër të dashur të Allahut ata padyshim se do të jenë të shpëtuar në jetën e përtejme dhe ata të cilët nënçmojnë të tjerët me krenarinë e tyre, janë të pavëmendshëm. Besimtar i vërtetë, në anën tjetër, është gjithmonë i nënshtruar përballë Allahut, është gjithmonë i vëmendshëm që të mos rrezikoj kënaqësinë e Tij dhe vepron me përvullje që kjo vetëdije sjell me vete.

Detyra e secilit Mysliman është të jetë besimtar i sinqertë, i nënshtruar, i devotshëm dhe i përvullur, pikërisht sikurse Profeti Jusuf (as) dhe të lutet me përplot sinqeritet, “më bën të vdes si Mysliman dhe më bashko me të mirët (të drejtët)!”

Gjatë gjithë këtij libri ne kemi analizuar jetën e Profetit Jusuf (as) në dritën e hollësive të dhëna në Kuran. I vetmi burim i sigurt i dijenisë sonë për jetën e tij është ai që na është dhënë prej

Allahut. Përtej kësaj, ne nuk kemi kurrfarë të drejte të shtojmë apo të heqim madje një fjalë të vetme. Allahu na ka treguar këtë në të vërtetë, duke zbuluar se gjithçka që është rrëfyer për Profetin Jusuf (as) në të vërtetë përbëhet prej gjërave të panjohura. Historia e Profetit Jusuf (as) përfundon me këto fjalë:

Këto janë nga ato lajme të panjohura, e Ne po t'i shpallim ty (Muhammed), se ti nuk ke qenë pranë tyre kur ata vendosën çështjen e tyre (hedhjen e Jusufit në pus etj.) dhe kur bënëin dredhi. (Sure Jusuf: 102)

Me zbulimin e këtij informacioni, Allahu na mëson një urtësi të rëndësishme, të cilën mund ta përdorim në jetët tona dhe gjithashtu na ka lehtësuar që ti marrin profetët e të kaluarës si model duke na mundësuar që të njihemi me ta. Me përjashtim të ëndrrave të vërteta (të cilat siç kemi vërejtur nga dëshmitë e vet jetës së Profetit, nuk janë ndodhi të zakonshme apo të përditshme), ne nuk kemi mundësi që t'i shohim vërtet Profetin Jusuf (as), Profetin Jakub (as) apo cilindo profet tjetër derisa jemi në këtë botë. Megjithatë, leximi i kujdesshëm i Kuranit dhe vlerësimi serioz i jetëve të profetëve, pamja e mjedisit në të cilin jetuan dhe e sjelljes së tyre shembullore qartë në mendjet tona dhe përpjekja për ta kuptuar atë, mund t'na lejojë që të njihemi me profetët dhe të fusin në përdorim aftësinë e tyre superiore të perceptimit, natyrën e tyre shpirtërore dhe afërsinë e tyre me Allahun.

Kushdo që lexon këtë libër duhet pra të mendoj me kujdes për këtë. Ata duhet të vlerësojnë urtësinë e profetëve Jakub (as) dhe Jusuf (as) dhe të gjejnë mënyrën se si ta bëjnë këtë urtësi

pjesë të jetës së tyre të përditshme. Nëse një njeri braktis shpresën përballë vështirësive dhe fatkeqësive që i ndodhin atij, apo nëse thotë: “Do të jetë shumë vështirë të rregullohet, nuk mund të bëjmë asgjë,” kur sheh gjendjen e vështirë të Myslimanëve, atëherë ne duhet të dimë se kjo është një pakujdesi e tmerrshme. Duhet ta kujtojmë durimin, vendosmërinë dhe besimin e paepur, të paluhatshëm në Allahun të Profetit Jusuf (as), i cili u hodh në pus, pastaj u shit si rob me çmim të ulët, u përgojua, u burgos pa bërë asnjë krim dhe u la aty me vite. Kështu duhet liruar nga defetizmi dhe dëshpërimi. Duhet të përkujtojmë se pavarësisht prej ngjarjeve fatkeqe që i ndodhën Profetit Jusuf (as) që dukeshin të jenë aq të mëdha nga pamja, ai u lirua prej tyre për një moment me zemërgjerësinë e Allahut dhe iu siguria një mirësi e madhe.

Kurrë mos harroni se në ditët tona, pikërisht sikurse në kohën e Profetit Jusuf (as), ekziston një plan i përsosur hyjnor që vepron në çdo gjë që ndodhë dhe se Allahu krijon gjithçka që ndodhë me ndihmën dhe urtësinë e Tij. Mos harroni se Allahu ka fuqi mbi çdo gjë, dhe se Ai gjithmonë i ndihmon ata që besojnë dhe janë sinqerisht të devotshëm ndaj Tij, të cilët me devotshmëri dëshirojnë t'i shërbejnë Atij dhe të pasojnë të Dërguarin e Tij (saas). Ai u dhuron mirësi besimtarëve atëherë kur më se paku shpresojnë dhe iu ndihmon atyre në mënyra të papritura. Detyra e vetme e qenies njerëzore është të adhuroj Allahun bazuar në këto të vërteta dhe ta jetoj jetën e tij në pajtim me to.

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Çdo detal në gjithësi tregon për një krijim superior. Për dallim, materializmi, i cili përpiqet të mohojë faktin e krijimit në gjithësi, nuk është asgjë tjetër përveç një ideje të gabuar joshkencore.

Me zhvlerësimin e materializmit, të gjitha teoritë tjera të bazuara në këtë filozofi janë bërë të pabaza. E para prej tyre është Darwinizmi, domethënë, teoria e evolucionit. Kjo teori, e cila pretendon se jeta u krijua prej materies së pajetë përmes rastësive, është hedhur poshtë me pranimin/miratimin se gjithësia u krijua prej Allahut. Astrofizikani Amerikan Hju Ros shpjegon këtë si vijon:

Ateizmi, Darwinizmi dhe praktikisht/pothuaj të gjithë "izmat" që burojnë nga filozofitë e shekullit nëntëmbëdhjetë dhe njëzet ngriten mbi supozimin, supozimin e gabuar, se gjithësia është e pafund. Veçantia na ka sjellë përballë me shkakun – apo shkaktarin – përtej, prapa, para gjithësisë dhe gjithçka përmban ajo, duke përfshirë vet jetën. ¹

Në ditën e sotme, ka njerëz të cilët jetojnë një jetë të larguar shumë prej Zotit dhe të cilët madje refuzojnë besimin dhe mohojnë ekzistencën e Zotit për qëllime vetjake të tyre. Për shkak të verbërisë së tyre dhe të guximit të pamend të tyre, ata përpiqen të ndikojnë tek të tjerët dhe t'i largojnë ata nga udha e Zotit. Ata kanë parashtruar një varg të tërë idesh kundërthënëse dhe ideologji të shtrembëruara me anën e të cilave ta arrijnë këtë. Njëra prej këtyre është teoria e evolucionit.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqafua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj

kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e Jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte bazën e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”²

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po për-

paronte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpyjekjet jobindëse në shekullin njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim: “Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.”³

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohej se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.⁴

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁵

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë? ⁶

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuar të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500

faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Meqenëse ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës Scientific American të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Gjithashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁷

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale. ⁸

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen

specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.⁹

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-Darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë

gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.¹⁰

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’-mund të bëjë asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: Asnjë gjurmë e formave

kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk-gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë **“forma kalimtare”**.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta

që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹¹

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.¹²

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar gjithashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth zanafillës së qenieve të gjalla. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga

ndonjë intelekt i plotfuqishëm. 13

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. *Australopiteku*
2. *Homo habilis*
3. *Homo erektus*
4. *Homo sapiens*

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. 14

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një

renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionit. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.” ¹⁵

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës. ¹⁶

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon. ¹⁷

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë. ¹⁸

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmëmajmun-gjysmënjeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave

propagandistike, s'janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitëkut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijjnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtëshqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtëshqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë. 19

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prod-

hojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpiknin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbi-zotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë

perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruesit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Deri më tani, asnjë aparat vizual apo regjistruer i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, sa i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria

e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar":

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materi-

alizmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore. ²⁰

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit është magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton bestytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolu-

cionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

E ata që mohuan, për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde. Ata do të përjetojnë një dënim të dhimbshëm. (Kuran, 2: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Kuran, 7: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të pamët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Kuran, 15: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë

ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

Ai (Musai) tha: "Hidhni ju!" E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. (Kuran, 7: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo "gëlltiti atë që ata kishin sajuar," siç përshkruhet në ajet.

E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" Kur ja, ai gëlltiste atë që kishin magjepsur. Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhduk ajo që kishin përgatitur. (Sure A'raf: 117-119)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata gjithashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia priset. Në të vërtetë, Malkolm

Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jobindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.²¹

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngritet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

Engjëjt thanë: “Larg nga të metat je

Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër

përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,

Ti je i Gjithëdijshtëm e i Urtë.”

(Kuran, Bekare: 32)

NOTES

1. Hugh Ross, *The Fingerprint of God*, p. 50
2. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4
3. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
4. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, pp. 1328-1330
5. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7
6. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40
7. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78
8. Charles Darwin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, New York, p. 127
9. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184
10. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
11. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179
12. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133
13. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, New York, 1983. p. 197
14. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389
15. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20
16. Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272
17. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans", *Time*, 23 December 1996
- 18.- S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30
19. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19
20. Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World", *The New York Review of Books*, January 9, 1997, p. 28
21. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43